

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
P. Nr. 180/08
30 mars 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ndërkombëtar, Emilio Gatti, si Kryetar i Trupit Gjykues, Gjyqtari Ndërkombëtar, Gianfranco Gallo dhe Gjyqtarja Vendore, Elmaze Syka, si anëtarë të trupit gjykues, në çështjen penale kundër të pandehurve

LULZIM THAQI, SADIK THAQI, SHQIPRIM UKA dhe ALI XERXA të akuzuar, sipas aktakuzës PP. Nr. 110/2008 të ngritur më 18.07.2008, të korrigjuar me anë të vendimit të Gjyqtarit Konfirmues, KP. Nr. 198/2008, të datës 16 shtator 2008, për veprat e mëposhtme penale

LULZIM THAQI, SADIK THAQI, SHQIPRIM UKA
Trafikimi i Qënieve Njerëzore, në kundërshtim me Nenin 139, Par. 1 & 3 dhe 23 të KPPK,

LULZIM THAQI, SADIK THAQI, SHQIPRIM UKA, ALI XERXA
Pastrimi i Parave, në kundërshtim me Seksionin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, Neni 10.2 (d), si të ndryshuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/53, dhe Neni 23 të KPPK,

LULZIM THAQI dhe SADIK THAQI
Mundësimi i Prostitucionit, në kundërshtim me Nenin 201 (3) dhe (1) dhe Nenin 23 të KPPK,

Pas gjykimit publik të zhvilluar në datat 28 dhe 29 janar, 3, 4, 19, 23, 24, 25 shkurt, 16 dhe 30 mars 2009, në prezencën e të pandehurve të mësipërm, Avokatëve të tyre Mbrojtës, Teki Bokshi, Orhan Basha, Mustafë Kastrati, Mybijene Sedefi, Prokurores Publike Speciale, Raze Loshaj, Përfaqësueses Ligjore të Palës së Lënduar, Merita Baloku, pas procesit të këshillim-votimit të mbajtur më 30 mars 2009, duke u bazuar në Nenin 391, Par. 1 dhe Nenin 392, Par. 1 të KPPK, publikisht shpall, në prezencën e të Akuzuarve, Avokatëve të tyre Mbrojtës, Prokurores Speciale, Përfaqësueses Ligjore të Palës së Lënduar, aktgjykimin e mëposhtëm:

AKTGJYKIM

I akuzuari ALI XERXA, emri i babait Rasim, emri i nënës Naxhije – mbiemri i vajzërisë Gorani, datëlindja 27.05.1952, profesioni – Punonjës Administrativ i Western Union-it në Gjakovë, vendlindja Gjakovë, vendbanimi Rruga "Nënë Tereza", Nr. 257, shtetësia

dhe kombësia shqiptar – kosovar, arsimimi – Fakulteti i Shkencave Politike, të ardhurat familjare – të mesme, statusi familjar – i martuar,

LIROHET

Nga vepra penale e Pastrimit të Parave, në kundërshtim me Nenin 11.2, Pikat a, b, d dhe e të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, sipas akuzës së dytë të aktakuzës së konfirmuar, meqë akti me të cilin akuzohet i akuzuari, nuk përbën vepër penale.

Në veçanti, sipas aktakuzës së konfirmuar, në Gjakovë, mes datave 1 mars 2004 dhe 31 dhjetor 2007, në datat e përmendura më poshtë, i pandehuri në bashkëpunim, i cili dinte apo kishte arsye të dinte, se prona të caktuara, të tilla si para, kanë pasur prejardhje të disa lloj veprimtarive kriminale – të tilla si mundësimi i prostitucionit dhe trafikimi i qënieve njerëzore – dhe paratë në fakt, janë të ardhura të përfuara nga krimi,

Akuza 2.3) *të shndërruara apo të transferuara për qëllimin apo për qëllimet e promovimit të veprimtarisë së fshehtë kriminale apo*

Akuza 2.4) *ka marrë, poseduar apo përdorur.*

Shumat e mëposhtme të parave:

A – një sasi prej 89.891,50 Euro në total, të transferuara nga Lulzim THAQI, në datat e përmendura në tabelat e transferimeve të parave, në dosjen 6, dokumentet 236 deri në 238 të dosjes së gjykatës

B – një sasi prej 34.970.00 Euro në total, të transferuara nga Sadik THAQI, në datat e përmendura në tabelat e transferimeve të parave, në dosjen 6, dokumentet 234 deri në 236 të dosjes së gjykatës

C – një sasi prej 5.200,00 Euro në total, të transferuara nga Shqiprim UKA, në datat e përmendura në tabelën e transferimeve të parave, në dosjen 6, dokumentin 234 të dosjes së gjykatës

D – një sasi prej 40.176,46 Euro në total, të transferuara nga _____, e cila nuk është arrestuar ende, në datat e përmendura në tabelat e transferimit të parave, në dosjen 6, dokumentet 232 deri në 234 të dosjes së gjykatës

E – një sasi prej 143.036,45 Euro në total, të transferuara nga gratë punonjëse që punonin nëpër klube, në datat e përmendura në tabelat e transferimit të parave, në dosjen 3, dokumentet 229 deri në 235 dhe dosjen 4, dokumentet 294 deri në 301 të dosjes së gjykatës

Sasia e përgjithshme e transferimeve të parave në Moldavi, nëpërmej Unionit Financiar në Prishtinë, Western Union, ishte 313.274,41 Euro. Këto transferta janë bërë me ndihmesën e të pandehurit Ali Xerxa, i cili, pavarësisht se e dinte apo kishte arsye për të

ditur që këto para ishin marrë në një mënyrë të paligjshme, ka lejuar transfertat në mungesë të personave të cilit në fakt kanë dhënë urdhrat e transfertave, që do të thotë, që ai ka qenë bashkëpunëtor në këtë çështje.

I akuzuari LULZIM THAQI, me pseudonimin Xiki, emri i babait Sahit, emri i nënës Sabrije – mbiemri i vajzërisë Lulaj, datëlindja 09.07.1977, vendlindja Gjakovë, vendbanimi fshati Osek-Hyle, Komuna e Gjakovës, kombësia dhe shtetësia shqiptar kosovar, arsimimi shkolla fillore, të ardhurat familjare – të mesme, statusi familjar – i martuar, në paraburgim që më 31.01.2008,

LIROHET

Nga vepra penale e Trafikimit të Qënieve Njerëzore, në kundërshtim me Nenin 139, Par. 1 dhe 3 të KPPK, sipas akuzës 1 të aktakuzës së konfirmuar, meqë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar.

Në veçanti, sipas aktakuzës së konfirmuar, në Gjakovë dhe Xerxë, mes 6 prillit 2004 dhe 31 janarit 2008, të pandehurit, Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka, në bashkëpunim me të pandehurën _____ dhe me një person që nuk është arrestuar ende,

_____, me qëllimin për të marrë një përfitim material, organizuan një grup njerëzish për të kryer veprën penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe rekrutuan, transportuan e strehuan gra nga Moldavia në shkëmbim të parave, me anë të përdorimit të mjeteve të kërcënimit apo forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, apo shpërdorimit të pozicionit, për t'i shfrytëzuar ato seksualisht si punonjëse seksi tek klubet "Vala", "Alaska" dhe "Makuba" në Gjakovë.

Personi që nuk është arrestuar ende, _____ dhe e pandehura _____ e kanë mbështetur rekrutimin e viktimave të reja nga Moldavia, duke marrë dhe dërguar kontrata punësimi dhe para për biletat e tyre të udhëtimit për në Kosovë. Veprat penale u zbuluan plotësisht kur hetuesit e policisë, në bazë të një urdhri gjykate të datës 31 janar 2008 rreth orës 06:20 bastisën hotel "Adorën" në fshatin Xerxë dhe hotel "Amsterdamin" në Gjakovë dhe i gjetën viktimat nëpër dhoma me klientët, të cilët atë natë i kishin paguar Lulzim dhe Sadik Thaqit për shërbime seksuale me gratë nga 100 Euro secili. Këto gra, meqë vareshin tërësisht prej tyre, ishin detyruar të siguronin shërbimet e tyre ndaj disa klientëve në mënyrë jo të vullnetshme.

DËNOHET

Për veprën penale të Pastrimit të Parave, në kundërshtim me Seksionin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, Nenit 10.2 (d), si të ndryshuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/53, dhe Nenit 23 të KPPK, sipas akuzës së dytë të aktakuzës, sepse mes fillimit të vitit 2007 dhe 31 dhjetorit të vitit 2007, në Gjakovë, i pandehuri, në bashkëpunim, duke pasur dijeni apo duke pasur shkak të dinte që objekte të veçanta, të tilla si para, ishin të ardhura të përfuara nga disa forma të veprimtarive kriminale – të tilla si mundësimi i prostitucionit – dhe paratë ishin kështu në fakt të ardhura ta përfuara nga krimi, ka transferuar për qëllimin apo qëllimet e promovimit të

aktivitetit të fshehtë kriminal, sasinë prej 25.190 Euro në Moldavi përmes Unionit Financiar në Prishtinë, Western Union,

Është

FAJTOR

Për veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit, në kundërshtim me Nenin 201 (3) dhe (1) dhe Nenin 23 të KPPK, në bazë të akuzës 3 A të aktakuzës së konfirmuar, sepse, që nga fillimi i vitit 2007 dhe deri nga 31 janari i vitit 2008, në Gjakovë, i akuzuari Lulzim Thaqi, si bashkëpronar i klubit "Makuba", në bashkëpunim, dhe në mënyrë të vazhdueshme, ka rekrutuar, ka organizuar dhe ka ndihmuar personat e lënduar,

dhe shumë gra të tjera, apo u ka siguruar atyre premise për qëllimet e prostitucionit. Gratë e sipërpërmendura, kishin punuar në klubet e tyre dhe janë shitur disa herë tek disa klientë të ndryshëm për shërbime seksuale.

PRANDAJ, i akuzuari,

DËNOHET

Me tri (3) vjet burgim dhe një gjobë prej 40.000 Eurosh për veprën penale të Pastrimit të Parave (Akuza 2);

Me një (1) vit burgim për veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit (Akuza 3 A);

Dënimi unik në bazë të Nenit 71, Par. 1 dhe 2, Nënparagr. 2 të KPPK, përcaktohet në tri (3) vjet e tetë (8) muaj burgim dhe një gjobë prej 40.000 Eurosh;

I akuzuari SADIK THAQI, emri i babait Ali, emri i nënës Gjyle, mbiemri i vajzërisë Lokaj, datëlindja 28.03.1964, me profesion kamarier, vendlindja fshati Osek-Hyle, Komuna e Gjakovës, kombësia dhe shtetësia shqiptar kosovar, arsimimi – shkolla e mesme, të ardhurat familjare - të mesme, statusi familjar – i martuar, në paraburgim që më 31.01.2008

LIROHET

Nga vepra penale e Trafikimit të Qënieve Njerëzore, në kundërshtim me Nenin 139, Par. 1 dhe 3 të KPPK, sipas Akuzës 1 të aktakuzës së konfirmuar, meqë nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Në veçanti, sipas aktakuzës së konfirmuar, në Gjakovë dhe Xerxë, mes 6 prillit 2004 dhe 31 janarit 2008, të pandehurit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka, në bashkëpunim me të pandehurën dhe një person që gjendet në arrati (nuk është arrestuar ende), me synimin për të siguruar përfitime materiale,

organizuan një grup personash për të kryer veprën penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe rekrutuan, transportuan e strehuan gra nga Moldavia në shkëmbim të parave, me anë të përdorimit të mjeteve të kërcënimit apo forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, apo shpërdorimit të pozicionit, për t'i shfrytëzuar ato seksualisht si punonjëse seksi tek klubet "Vala", "Alaska" dhe "Makuba" në Gjakovë.

Personi që nuk është arrestuar ende, dhe e pandehura e kanë mbështetur rekrutimin e viktimave të reja nga Moldavia, duke marrë dhe dërguar kontrata punësimi dhe para për biletat e tyre të udhëtimit për në Kosovë. Veprat penale u zbuluan plotësisht kur hetuesit e policisë, në bazë të një urdhri gjykatë të datës 31 janar 2008 rreth orës 06:20 bastisën hotel "Adorën" në fshatin Xerxë dhe hotel "Amsterdamin" në Gjakovë dhe i gjetën viktimat nëpër dhoma me klientët, të cilët atë natë i kishin paguar Lulzim dhe Sadik Thaçit për shërbime seksuale me gratë nga 100 Euro secili. Këto gra, meqë vareshin tërësisht prej tyre, ishin detyruar të siguronin shërbimet e tyre ndaj disa klientëve në mënyrë jo të vullnetshme.

Është

FAJTOR

Për veprën penale të Pastrimit të Parave, në kundërshtim me Seksionin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, Nenit 10.2 (d), sit ë ndryshuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/53, dhe Nenit 23 të KPPK, sipas akuzës 2 të aktakuzës së konfirmuar, sepse mes fillimit të vitit 2007 dhe 31 dhjetorit të vitit 2007, në Gjakovë, i pandehuri, në bashkëpunim, duke pasur dijeni apo duke pasur shkak të dinte që objekte të veçanta, të tilla si para, ishin të ardhura të përfutuara nga disa forma të veprimtarive kriminale – të tilla si mundësimi i prostitucionit – dhe paratë ishin kështu në fakt të ardhura ta përfutuara nga krimi,

ka transferuar për qëllimin apo qëllimet e promovimit të aktivitetit të fshehtë kriminal,

sasinë prej 25.190 Euro në Moldavi përmes Unionit Financiar në Prishtinë, Western Union,

Është

FAJTOR

Për veprën penale të Mundësimi të Prostitucionit, në kundërshtim me Nenin 201 (3) dhe (1) dhe Nenin 23 të KPPK, në bazë të akuzës 3 A të aktakuzës së konfirmuar, sepse mes fillimit dhe deri më 31 janar 2008, Sadik Thaqi, si bashkëpronar i klubit "Makuba", në bashkëpunim, dhe në mënyrë të vazhdueshme, ka rekrutuar, ka organizuar dhe ka ndihmuar personat e lënduar,

dhe shumë gra të tjera, apo u ka siguruar atyre premise për qëllimet e prostitucionit. Gratë e sipërpërmendura, kishin punuar në klubet e tyre dhe janë shitur disa herë tek disa klientë të ndryshëm për shërbime seksuale.

PRANDAJ, i akuzuari

DËNOHET

Me tri (3) vjet burgim dhe një gjobë prej 40.000 Eurosh për veprën penale të Pastrimit të Parave, (Akuza 2);

*Me një (1) vit burgim për veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit, (Akuza 3 A);
Dënimi unik, në bazë të Nenit 71, Par. 1 dhe 2, Nënparagr. 2 të KPPK, përcaktohet në tri (3) vjet e tetë (8) muaj burgim dhe një gjobë prej 40.000 Eurosh;*

I akuzuari SHQIPRIM UKA, emri i babait Asllan, emri i nënës Vjollca, mbiemri i vajzërisë Thaqi, datëlindja 03.07.1986, profesioni mekanik makinash, vendlindja Gjakovë, vendbanimi Pejë, rruga "Sali Jaha", Nr. 16, kombësia dhe shtetësia shqiptar kosovar, arsimimi – ka kryer shkollën e mesëme, të ardhurat familjare – i varfër, statusi familjar – beqar, në paraburgim për një vepër tjetër penale,

Është

FAJTOR

Për veprën penale të Pastrimit të Parave, në kundërshtim me Seksionin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, Nenit 10.2 (d), si të ndryshuar me anë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/53, dhe Nenit 23 të KPPK, sipas akuzës 2 të aktakuzës së konfirmuar, sepse mes 15 marsit 2007 dhe 24 shtatorit të vitit 2007, në Gjakovë, i pandehuri, në bashkëpunim, duke pasur dijeni apo duke pasur shkak të dinte që objekte të veçanta, të tilla si para, ishin të ardhura të përfuara nga disa forma të veprimtarive kriminale – të tilla si mundësimi i prostitucionit – dhe paratë ishin kështu në fakt të ardhura ta përfuara nga krimi,

ka transferuar për qëllimin apo qëllimet e promovimit të aktivitetit të fshehtë kriminal,

sasinë prej 5.220 Euro në Moldavi përmes Unionit Financiar në Prishtinë, Western Union,

Është

FAJTOR

Për veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit, në kundërshtim me Nenin 201 (3) dhe (1) dhe Nenin 23 të KPPK, në bazë të akuzës 3 A të aktakuzës së konfirmuar, sepse mes fillimit dhe deri më 31 janar 2008, Sadik Thaqi, si bashkëpronar i klubit "Makuba", në bashkëpunim, dhe në mënyrë të vazhdueshme, ka rekrutuar, ka organizuar dhe ka ndihmuar personat e lënduar,

Ursu, dhe shumë gra të tjera, apo u ka siguruar atyre premise për qëllimet e prostitucionit. Gratë e sipërpërmendura, kishin punuar në klubet e tyre dhe janë shitur disa herë tek disa klientë të ndryshëm për shërbime seksuale.

PRANDAJ, i akuzuari

DËNOHET

Me një (1) vit e tetë (8) muaj burgim dhe me një gjobë prej 9.000 Eurosh për veprën penale të Pastrimit të Parave (Akuza 2);

Me nëntë (9) muaj burgim për veprën penale të Mundësimit të Prostitucionit (Akuza 3 A), kështu që riklasifikohet akuza origjinale për veprën penale të Trafikimit të Qënieve Njerëzore;

Dënimi unik, sipas Nenit 71, Par.(1) dhe (2), Nënparagr. 2 të KPPK, përcaktohet me dy (2) vjet burgim dhe një gjobë prej 9.000 Eurosh;

Koha e shpenzuar në paraburgim nga të pandehurit Lulzim Thaqi dhe Sadik Thaqi, deri më 30 mars 2009, do të llogaritet përkundrejt këtij dënimi, në bazë të Nenit 391, Par. (1), Nënparagr. (5) të KPPK.

Të akuzuarit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shqiprim Uka do të paguajnë shpenzimet e procedurës penale, në bazë të Nenit 102, Par. (1) të KPPK, me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit me gojë e me shkrim. Gjykata do të lëshojë një urdhër të veçantë në lidhje me sasinë e shpenzimeve që do të paguhen, pasi të merren të dhëna të tilla, në bazë të Nenit 100, Par. (2) të KPPK.

ARSYETIMI

A. TË DHËNAT PROCEDURIALE – AKTAKUZA

Më 18 korrik 2008, Prokurorja Publike Speciale ngriti aktakuzën me Nr. PP. 110/2008 në Gjykatën e Qarkut Pejë, kundër të pandehurve Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka dhe Ali Xerxa, duke i akuzuar ata për veprat penale të Trafikimit të Qënieve Njerëzore, e kryer në bashkëpunim, në kundërshtim me Nenin 139, Par. 1 & 3 dhe Nenin 23 të KPPK, Pastrimit të Parave, në kundërshtim me Nenin 11.2, Pikat a, b, d dhe e të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2, (sit ë ndryshuar me anë të Seksionit 1, Pika k e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/9, dhe të riemërtuar si Pika h, fjalia e fundit e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/53) dhe nenit 23 të KPPK, dhe Mundësimit të Prostitucionit, në kundërshtim me Nenin 201.1 dhe Nenin 23 të KPPK.

Më 16 shtator 2008, Gjyqtari Konfirmues korrigjoi disa pjesë të aktakuzës. Sipas aktakuzës së korrigjuar, akuzat ndaj të pandehurve janë përcaktuar si më poshtë vijon:

“Akuza 1: Kundër të pandehurve Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka, në bashkëpunim me

Në Gjakovë dhe Xerxë, mes datave 6 prill 2—4 dhe 31 janar 2008.

TRAFIKIM I OËNIEVE NJERËZORE NË BASHKËPUNIM, në kundërshtim me Nenin 139, Par. 1 dhe 3 dhe Nenin 23 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK), të ndëshkueshëm me një gjobë deri në 500.000 Euro dhe me burgim nga shtatë e deri në njëzet vjet.

Të pandehurit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka në bashkëpunim me të pandehurën _____ dhe një person që gjendet në arrati (nuk është arrestuar ende), _____, me synimin për të siguruar përfitime materiale, organizuan një grup personash për të kryer veprën penale të trafikimit të qënieve njerëzore dhe rekrutuan, transportuan e strehuan gra nga Moldavia në shkëmbim të parave, me anë të përdorimit të mjeteve të kërcënimit apo forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, apo shpërdorimit të pozicionit, për t'i shfrytëzuar ato seksualisht si punonjëse seksi tek klubet “Vala”, “Alaska” dhe “Makuba” në Gjakovë.

Personi që nuk është arrestuar ende, _____ dhe e pandehura _____ e kanë mbështetur rekrutimin e viktimave të reja nga Moldavia, duke marrë dhe dërguar kontrata punësimi dhe para për biletat e tyre të udhëtimit për në Kosovë. Veprat penale u zbuluan plotësisht kur hetuesit e policisë, në bazë të një urdhri gjykate të datës 31 janar 2008 rreth orës 06:20 bastisën hotel “Adorën” në fshatin Xerxë dhe hotel “Amsterdamin” në Gjakovë dhe i gjetën viktimat nëpër dhoma me klientët, të cilët atë natë i kishin paguar Lulzim dhe Sadik Thaqit për shërbime seksuale me gratë nga 100 Euro secili. Këto gra, meqë vareshin tërësisht prej tyre, ishin detyruar të siguronin shërbimet e tyre ndaj disa klientëve në mënyrë jo të vullnetshme.

Akuza 2: Kundër të pandehurve Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka, Ali Xerxa dhe

Në Gjakovë, mes datave 1 mars 2004 dhe 31 dhjetor 2007, në datat e përmendura më poshtë

PASTRIM PARASH, në kundërshtim me Nenin 11.2, Pikat a, b, d dhe e të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2004/2 (si të ndryshuar me Seksionin 1, Pika k e Rregullores së UNMIK-ut 2005/9 dhe të riemërtuar si Pika h, fjalia e fundit e Rregullores së UNMIK-ut 2006/53), dhe Nenin 23 të KPPK, të ndëshkueshëm të riemërtuar si Pika h, fjalia e fundit e Rregullores së UNMIK-ut 2006/53), dhe Nenin 23 të KPPK, të ndëshkueshëm me burgim deri në dhjetë vjet dhe me një gjobë tri herë më të madhe se sa vlera e pronës që është subjekt i veprës penale.

Të pandehurit në bashkëpunim, të cilët kishin dijeni apo kishin arsye të ishin në dijeni se një pronë e caktuar, si para të thata, buron nga ndonjë aktivitet kriminal – psh mundësimi I prostitucionit dhe trafikimi me njerëz – dhe paratë burojnë në fakt nga vepra penale,

Akuza 2.1) këmbimi apo transferta me qëllim apo qëllime të fshehjes apo mbulimit të natyrës, burimit, vendit, sistemimit, lëvizjes apo pronësia e pronës,

Akuza 2.2) këmbimi apo transferta për qëllim apo qëllime për të ndihmuar ndonjë person I.përfshirë në, apo në dukje I përfshirë në kryerjen e veprës penale që burojnë nga pasuria për të shmangur pasojat ligjore apo pasojat e dukshme ligjore të veprimeve të tij apo të saj,

Akuza 2.3) këmbimi apo transferta me qëllim përkrahjen e aktivitetit kriminal apo

Akuza 2.4) sigurimin, posedimin apo përdorimin.

Shumat e parave siç vijojnë:

A – shumën totale 89.891,50 EUR, e transferuar nga Lulzim THAQI në datat e shënuara në tabelën e transfertës së parave, fashikulli 6, dokumentet 236 deri 238 të dosjes së lëndës

B – shumën totale 34.970,00 EUR, e transferuar nga Sadik THAQI në datat e shënuara në tabelën e transfertës të parave, fashikulli 6, dokumentet 234 to 236 të dosjes së lëndës

C – shumën totale 5.200,00 EUR, transferuar nga Shqiprim në datat e shënuara në tabelën e transfertës së parave, fashikulli 6, dokumentet 234 të dosjes së lëndës

D – shumën totale 40.176,46 EUR, transferuar nga aktualisht në arrati, në datat e shënuar në tabelën e transfertës të parave, fashikulli 6, dokumentet 232 deri 234 të dosjes së lëndës

E – shumën totale 143.036,45 EUR, transferuar nga punonjëset e gjinisë femërore të cilat kanë punuar në klube, në datat e shënuara në tabelën e transfertës së parave, fashikulli 3, dokumentet 229 deri 235 dhe fashikulli 4, dokumentet 294 deri 301 të dosjes së lëndës

Shuma totale e parave transferuar në Moldavi nëpërmjet Njesisë Financiare në Prishtinë/Priština, Western Union, është 313.274,41 Euro. Këto transferta janë bërë me ndihmën e të pandehurit Ali Xerxa I cili, megjithëse ishte në dijeni apo kishte arsye për të qenë në dijeni se paratë ishin siguruar në mënyrë të paligjshme, ka lejuar transfertat edhe pse personat të cilët në fakt jepnin urdhrat për transfertë, nuk ishin të pranishëm; kjo do të thotë që ai ka qenë bashkëpunues në këtë lëndë.

Akuza 3: Kundër të pandehurve Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi

Akuzë 3 A. Në Gjakovë nga data 29 tetor 2003 deri 31 janar 2008

MUNDESIMI I PROSTITUCIONIT, në kundërshtim me Nenin 201.1 dhe Nenin 23 të KPPK-SË, veprimtari kriminale në kundërshtim me Nenin 251.1LP I RFSJ, para hyrjes në fuqi të KPPK

Gjatë periudhës kohore 2003 dhe 2008, të pandehurit Lulzim Thaqi dhe Sadik Thaqi, si bashkëpronarë të klubit "Makuba", në bashkëpunim dhe në mënyrë të vazhdueshme kanë rekrutuar, organizuar, dhe asistuar personat e palës së dëmtuar dhe shumë femra të tjera, apo kanë siguruar locale për to me qëllim prostitucioni. Femrat e lartpërmendura kanë punuar në klubet e tyre ku janë shitur herë të ndryshme klientëve për shërbime seksuale, siç është përshkruar në dispozitivin e parë të kësaj Aktakuze.

Akuzë 3 B. Në Gjakovë, nga 29 tetor 2003 deri 31 janar 2008

MUNDESIMI I PROSTITUCIONIT, në kundërshtim me Nenin 201.1 dhe Nenin 23 të KPPK-së, veprimtari kriminale në kundërshtim me Nenin 251.1LP I RFSJ, para hyrjes në fuqi të KPPK

Gjatë periudhës kohore 2003 dhe 2008, të pandehurit Lulzim Thaqi dhe Sadik Thaqi, si bashkëpronarë të klubit "Makuba", në bashkëpunim dhe në mënyrë të vazhdueshme kanë detyruar palët e dëmtuara dhe shumë femra të tjera që të angazhohen në prostitucion duke i mbajtur në varësi ekonomike dhe personale, sepse femrat e lartpërmendura kishin punuar në klubet e tyre dhe ishin shitur herë të ndryshme për qëllime dhe shërbime prostitucioni siç është përshkruar në dispozitivin e parë të kësaj Aktakuze.

Pasi ka korrigjuar aktakuzën, në vendimin e tij, gjyqtari konfirmues ka konfirmuar vetëm pjesët e aktakuzës në vijim:

- Në lidhje me të pandehurin Lulzim Thaqi aktakuza është konfirmuar për pikat e akuzës 1, 2.3 (për të gjitha transfertat e bëra të përmendura në pikat A, B, C, D dhe E), 2.4 (për të gjitha transfertat e bëra në pikat A, B, C, D dhe E) dhe 3A.
- Në lidhje me të pandehurin Sadik Thaqi aktakuza është konfirmuar për pikat e akuzës 1 (në periudhën kohore 17 tetor 2005 deri 31 janar 2008), 2.3 (për të gjitha transfertat e përmendura në pikat A, B, C, D dhe E në periudhat kohore 10 qershor 2005 deri 31 dhjetor 2007), 2.4 (për të gjitha transfertat e përmendura në pikat A, B, C, D dhe E në periudhat kohore 10 qershor 2005 deri 31 dhjetor 2007) dhe 3A (nga 17 tetori 2005 deri 31 janar 2008).
- Në lidhje me të pandehurën aktakuza është hedhur.

- Në lidhje me të pandehurin Shqiprim Uka akatakuza është konfirmuar në lidhje me pikat e akuzës 1 (në periudhën kohore 25 qershor 2005 deri 31 janar 2008), 2.3 (për transfertat e përmendura në pikën C në periudhën kohore 15 mars 2007 deri 24 shtator 2007) dhe 2.4 (për transfertat e përmendura në pikën C në periudhën kohore 15 mars 2007 deri 24 shtator 2007).
- Në lidhje me të pandehurin Ali Xerxa aktakuza është konfirmuar për pikat e akuzës 2.3 dhe 2.4.

Prokurori i Prokurorisë Speciale dhe avokatët mbrojtës të Lulzim Thaqit dhe Sadik Thaqit kanë bërë ankesë kundër vendimit mbi konfirmimin e aktakuzës. Ankesa e prokurorit është refuzuar si e pabazuar me vendimin e Panelit me tre gjyqtarë KAQ.nr.198/08 më datë 21.10.2008. Ankesa e avokatëve mbrojtës u konsiderua si e papranueshme nga Paneli me tre gjyqtarë me vendimin KAQ.nr.198/08 i datës 14.01.2009. Për këtë arsye u shpall aktakuza e konfirmuar. Gjykimi kryesor filloi më datë 28 janar.

A. KOMPETENCA E TRUPIT GJYKUES

1. Procedura, Kompetenca dhe Përbërja e Trupit Gjykses të Gjykatës së qarkut Peje.

Në pajtim nenin 23 paragrafi 1 i KPPK-së, Gjykatat e Qarkut kanë juridiksion për të gjykuar në shkallë të parë veprat penale që dënohen me të paktën pesë vjet burgim apo me burgim afatgjatë.

Në rastin në fjalë të akuzuarit akuzohen për veprën penale të Trafikimit të Qenieve Njerezore në Bashkëpunim në kundërshtim me Nenet 139 par. 1 dhe 3 në lidhje me nenin 23 të KPK-së vepër penale që dënohet me gjobë deri 500,000 € dhe me burgim nga shtatë deri njëzet vjet; Pastrim Parash në kundërshtim me Nenin 11.2 pikat a, b, d dhe e të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/2, (e amenduar nga seksioni 1 pika k e UNMIK/REG/2005/9 dhe siç është rinumëruar nga pika h, fjalia e UNMIK/REG/2006/53) dhe Neni 23 i KPK, vepër penale që dënohet me burgim deri dhjetë vjet dhe me gjobë deri tre herë vlerën e pasurisë që është subjekt i një vepre penale; dhe Mundësimi i Prostitucionit në kundërshtim me Nenin 201 par. 3 dhe 1, dhe Neni 23 i KPK-së, vepër penale që dënohet nga një deri tetë vjet burgim.

Sipas aktakuzës, veprat penale janë kryer në Gjakovë, e cila është në territorin e Gjykarës së Qarkut të Pejës, kjo është domethënë në pajtim me nenin 27 par. 1 i KPPK-së, Gjykata e Qarkut të Pejës ka juridiksion territorial që të gjykojë lëndën në fjalë.

Për këtë arsye, është e padiskutueshme se Gjykata e Qarkut Peje ka juridiksionin e çështjes për të gjykuar lëndën në fjalë.

Veç kësaj, në pajtim me Nenin 3 të Ligjit mbi Juridiksionin (LmJ), Përzgjedhja e Lëndëve dhe Caktimi i Lëndëve Gjyqtarëve dtë EULEX-it dhe Prokurorëve në Kosovë. Gjyqtarët e EULEX-it që janë të caktuar në procedimet penale kanë juridiksion dhe competence mbi çfarëdo lloj lënde që hetohet apo ndiqet penalisht nga Prokurorët Specialë të Republikës së Kosovës.

Meqënëse lënda në fjalë është hetuar dhe paditur nga Zyra e Prokurorisë Speciale të Kosovës, Trupi Gjykues I Gjykatës së Qarkut Peja/Pec përbëhet në mënyrë korrekte të nga dy Gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtar Vendor në pajtim me Nenin 4.7 të LmJ-së. Palët nuk kanë bërë vërejtje apo kundërshtim në lidhje me kompetencën e gjykatës dhe përbërjen e Trupit Gjykues.

2. Shqyrtimi Kryesor

Shqyrtimi kryesor filloi me dyer të hapura më datë 28, 29 janar, 03, 04, 19, 23, 24, 25 shkurt, 16 dhe 30 mars 2009, në prani të të akuzuarve Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi, Shqiprim Uka dhe Ali Xerxa, avokatët e tyre mbrojtës Teki Bokshi, Orhan Basha, Mustafe Kastrati, Mybijene Sedefi, Prokurori Special Publik Raze Loshaj, përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar Merita Baloku.

Në pajtim me Nenin 15 të KPPK-së, përkthyesit ndërkombëtarë kanë përkthyer gjatë shqyrtimit kryesor si dhe të gjitha dokumentet relevante rre shqyrtimit në shqip dhe anglisht sipas nevojës.

B. PËRMBLEDHJE E PROVAVE TË PARAQITURA

1. Gjatë procedurave të shqyrtimit kryesor u dëgjuan dëshmitarët si në vijim:

- a) [] si dëshmitare dhe palë e dëmtuar në datë 29 janar 2009
- b) [] si dëshmitare dhe palë e dëmtuar në datë 29 janar 2009
- c) [] si dëshmitar më datë 03 shkurt 2009
- d) [] si dëshmitar në datë 04 shkurt 2009
- e) [] si dëshmitar në datë 04 shkurt 2009
- f) [] si dëshmitar në datë 04 shkurt 2009
- g) [] si dëshmitar në datë 19 shkurt 2009

1. a) [] gjatë dëshmisë së saj para Trupit Gjykues, ka deklaruar se ka ardhur në Kosovë në 2005, për të punuar në klub si kamariere. Kjo punë asaj i ishte ofruar nga një shoqe me emrin []. Kur arriti në Kosovë në aeroport po e priste një burrë me emrin Luli.

Pagesa mujore ishte 150 € dhe orari i punës nga 19:00 deri 00:00. Pas orarit të punës ajo ishte e lirë dhe askush nuk e ka detyruar të punonte më tej dhe asaj nuk i është dashur të kërkojë kurrë leje për t'u larguar nga klubi. Në kohën kur ajo ka punuar në klub aty punonin edhe pesë vajza të tjera por asaj nuk i kujtoheshin emrat e tyre. Klubi ku ajo punonte quhej Vala, më pas iu ndryshua në Alaska në kohën kur pronar i klubit u bë Lulzim Thaqi. Kur klubit iu vu emri Macuba, pronar i klubit ishte Sadik Thaqi. Kur ajo u

arrestua, më datë 30 janar 2008, ajo ishte vetëm në hotel Adora. Ajo mohoi se ajo ka qenë duke punuar si prostitutë në klubet e lartpërmendura.

1. b) në dëshminë e saj para Trupit Gjykses ka deklaruar se ka ardhur në Kosovë para tre vjetësh, më datë 09 mars 2006. Asaj i është ofruar punë në Kosovë nëpërmjet një shoqeje me emrin _____ e cila tashmë punonte atje. Asaj i është dërguar një me faks kontratë pune në Moldavi nga pronari i saj Sadik Thaqi i cili gjithashtu e ka pritur në aeroport kur ka ardhur në Kosovë. Ditën pasuese ajo ka filluar punë në Kosovë si banakiere; ajo deklaroi se pagesa e saj mujore ishte 150 €, por se ajo ka fituar më shumë para nga bakshishet dhe qerasjet e klientëve. Orari i punës ishte nga 19:00 deri 00:00; pas orarit të punës ajo ishte e lirë të bënte atë që donte. Ajo i dërgonte para familjes në Moldavi nëpërmjet Western Union. Ajo mohon faktin se ka punuar si prostitutë në klubet e lartpërmendura.

1. c) _____, në dëshminë e tij para Trupit Gjykses ka thënë se ai ka qenë me kushëririn e tij _____ kur ka qenë në klubin Macuba, dhe se të dy kanë qenë në gjendje të dehur. Atij i kishte lënë përshtypje një nga kamarieret dhe i kishte kërkuar asaj të shkonte me të, por ajo i ishte përgjigjur se duhet të pyeste shefin e saj nëse mund të largohej me të; ajo i kishte dhënë numrin e telefonit të Sadik Thaqit ku ai kishte telefonuar një ditë më pas dhe kishte folur me Sadik Thaqin me të cilin ishte marrë vesh që ta merrte vajzën për një orë. Dëshmitari, para Trupit Gjykses, i është treguar një fotografi nga prokurori dhe ai ka identifikuar vajzën si _____. Më vonë ai ka marrë vajzën dhe kanë shkuar në hotel Amsterdam ku ai pagoi 25 euro për dhomën dhe, pas marrëdhënies seksuale me vajzën, ai i ka dhënë asaj 100 Euro.

Gjatë marrjes në pyetje dëshmitari është ballafaquar me deklaratën e mëparshme dhënë në polici, siç vijon (procesverbali i datës 3.2.2009):

:: Unë i ofrova asaj një pije apo një shujtë, një "qerasje".

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Kur shkuat në hotel a i dhatë asaj para apo jo?

Unë pagova për dhomën në reception.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Vetëm për dhomën apo edhe për vajzën?

:: Unë e "qerasa" vajzën por nuk jam i sigurt se sa.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Ne duhet të jemi saktë. "Qerasja" nënkupton ti ofrosh dikujt një shujtë apo diçka, mëse e kam kuptuar këtë frazë vendore. Pyetja është, a keni paguar diçka për shërbimet seksuale të vajzës?

Orhan Basha: Ju lutem, ai i është përgjigjur tashmë pyetjes. Ai tha se ai e ka "qerasur" atë.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Përkthimi nuk është i qartë, pra po e pyes përsëri.

Jo.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Sepse tani duhet t'u ballafaqoj me deklaratën tuaj të mëparshme të dhënë në Prokurorinë Publike më datë 8 prill 2008, në të cilën ju thoni (citon) "unë pagova 25 Euro për dhomën dhe dhashë 100 Euro për vajzën. U largova nga hoteli pas një ore." Pra kjo është deklarata juaj?

: Po, aty thuhet se i kam dhënë asaj 100 Euro.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Për shërbime seksuale?

.....: Me një fjalë, unë them se e kam "qerasur" atë.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Po, por ne duhet ta dimë këtë me saktësi. Ju lutem përgjigjuni pyetjes.

: Cila ishte pyetja?

Gjyqtari Gianfranco Gallo: A e keni paguar atë 100 Euros për shërbime seksuale?

Orhan Basha: Unë kundërshtoj mënyrën se si bëhet pyetja. Pse nuk e pyesni atë se pse i dha asaj para? Përndryshe Procesverbali është i papranueshëm. Procesverbali pastaj përpilohet në kundërshtim me Nenin 89 të KPPPK-së.

Presiding Gjyqtari: Ju lutem përgjigjuni pyetjes. A keni paguar 100 Euro për shërbime seksuale apo jo?

.....: Unë e "qerasa" vajzën.

Presiding Gjyqtari: Po ju pyes, keni kryer marrëdhënie seksuale me këtë vajzë apo jo?

: Po, sigurisht.

Presiding Gjyqtari: Dhe a keni paguar 100 Euro apo jo?

Po

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Shumë mirë. Para se të pyesnit shefin, a keni biseduar me dikë tjetër për të marrë leje që të dilni me vajzën ".....". A keni biseduar me dikë tjetër në lidhje me lejen?

.....: Jo, unë folam me vajzën.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Po u ballafaqoj me deklaratën tuaj të mëparshme të dhënë në Prokurori më datë 8 prill 2008, pyetjes (citon) "A u është dashur të pyesni dikë tjetër

përveç shefit për të marrë vajzën për shërbime seksuale?" ju i jeni përgjigjur (citon) "Po, pyeta rojen e barit. Ai më tha se nuk mund ta marr atë pa lejen e shefit", Sqaroj se ky është versioni anglisht të cilin kam këtu, (citon) "por hajde më vonë dhe tako shefin pasi ai nuk është këtu." Kjo ishte përgjigja juaj. Pra, ju keni thënë se ju keni pyetur në fillim rojen. Tani po ua përkujtoj, a u kujtohet më mirë?

.....: Po, më parë u thashë se mund të lexoni deklaratën dhe i qëndroj deklaratës që kam dhënë.

Veç kësaj, gjatë marrjes në pyetje të Prokurori i la dëshmitarit të dëgjonte një bisedë telefonike të datës 14 tetor 2007, në orën 14:21, midis numrit të telefonit 044 348405 dhe numrit të telefonit 044386666: gjatë kësaj bisede telefonike janë dy meshkuj që flasin në mënyrë të qartë në lidhje me punësimin e një vajze për shërbime seksuale: është qartësisht e njëjta bisedë telefonike për të cilën foli dëshmitari kur tha se vajza që ai zgjodhi i ka thënë atij se në fillim ai duhet të fliste me shefin e saj. Gjatë marrjes në pyetje, dhe gjithashtu pasi ai është ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme, dëshmitari në një farë mënyre pranoi se zëri i personit që bëri thirrjen telefonike ishte zëri i tij (procesverbali i tij of 3.2.2009):

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Ju keni thënë vazhdimisht se atë natë keni qenë i dehur, por sot jo?

..... Jo.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Pra, sot ju e njihni zërin tuaj në atë bisedë meqënëse ju sot nuk jeni i dehur?

.....: Po, siç duket ishte zëri im.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Siç duket apo është?

.....: Nuk jam i sigurt.

Gjyqtari Gianfranco Gallo: Pra, po u ballafaqoj me deklaratën tuaj të mëparshme dhënë në Prokurorinë Publike më datë 8 shkurt 2008, ku thuhet se incizimi i përgjimit i është lënë për dëgjim dëshmitarit dhe se ai deklaroi se kjo është bisedë që ai ka pasur me shefin e kafesë Sadik Thaqi. Pra është e qartë, kur ju keni qenë në Prokurorinë Publike ju keni deklaruar se ishte biseda që keni pasur me Sadik Thaqin, ju e keni njohur zërin tuaj dhe keni thënë se ajo ishte biseda. Pra cila është përgjigja juaj tani?

Nuk di çfarë të them; ndoshta është zëri im.

1. d), në dëshminë e tij para Trupit Gjykesor tha se ai njihnte të pandehurit thjesht si qytetarë të Gjakovës dhe se ai ka riparuar makinat e Lulzim dhe Sadik Thaqit. Një herë Lulzim Thaqi i ka kërkuar atij të transferojë një shumë parash në Gjermani nëpërmjet Western Union meqënëse atij i kishte vdekur motra dhe nuk ishte në

qytet që t' i dërgonte paratë vetë. Pra kur ai vajti në zyrën e Western Union ai tha atje se kishte ardhur të bënte një transfertë parash në emër të Lulzim Thaqit. Punonjësit atje i kishin dhënë disa formularë për të mbushur dhe atij nuk i ishte dashur që të jepte para pasi Lulzimi kishte rregulluar çdo gjë vetë. Ai nuk dinte as shumën e parave që duhej të dërgonte meqënëse e vetmja gjë që ai duhej të bënte ishte të firmoste disa formularë. Ai thjesht i bëri Lulzimit një favor. Ai ka vajtur në klubet Alaska and Macuba pasi kishte dërguar makinat e riparuar te Lulzimi dhe Sadiku. Më vonë atij iu kërkua që të riparonte gjeneratorin e klubit. Ai dinte se vajzat punonin aty vetëm si kamariere.

1. e) _____, në dëshminë e tij para Trupit Gjykses deklaroi se ai, bashkë me _____ rastësisht kishte ndaluar të pinte diçka rreth orës 22:00 ose 23:00. Deklarata e dhënë nga dëshmitari në polici mban datën 6.11.2007. Ata ishin shërbyer në klub nga një kamariere. Pasi kishin pirë diçka kishin vajtur në shtëpi. Gjatë deklaratës dëshmitari është ballafaquar nga Prokurori në lidhje me deklaratën e dhënë në polici nga dëshmitari (procesverbali i datës 4.2.2009):

Prokurori Publik: Po, desha vetëm të saktësoj nëse ka paguar ai apo kolegu i tij. Shkuat ju në hotel Adora atë natë?

: Jo.

Prokurori Publik: Ku shkuat pasi u larguat nga bar Makuba?

..... Unë shkova në shtëpinë time dhe ai në të vetën.

...

Prokurori Publik: "a morrët ndonjë vajzë me vete atë natë....., përgjigja ishte, unë morra një vajzë me vete, nuk pagova dhe nuk kisha ndonjë lidhje me të". Pyetja ishte "kush pagoi" dhe përgjigja është ".....".

: Nuk është e vërtetë se kam thënë se pagoi apo se kemi marrë vajza. Ju mund ta keni ngatërruar atë me pagesën e pijeve.

International Gjyqtari: Kjo është një deklaratë që ju e keni firmosur.

:Unë nuk e kam thënë këtë kurrë dhe nuk është e vërtetë se kam marrë një femër me vete.

Prokurori Publik: Pyetja tjetër ishte "si i keni zgjedhur vajzat", përgjigja ishte "ne nuk i zgjodhëm ato, ne vajtëm në Hotel Adora dhe ato erdhën pastaj".

Ardian racaj: Me vjen keq por ju ndoshta jeni duke e lexuar deklaratën e

Prokurori Publik: Jo, kjo është deklarata e juaj.

Une nuk kam thënë se kam shkuar në Adore, në kemi paguar 20 Euro për pijet tona. Jo, atë nuk e kam thënë.

Kryetar i kolegjit, a mund të sugjeroj që të tregoni deklaratën e tij, pjesën të cilën e kontestoni dhe nënshkrimin e tij?

.....

Gjykatesi vendor: Në deklaratën e dhënë në Zyren e Prokurorisë në faqen 3 (citat), "Dola nga bari dhe shkova në veturë, kurse mbeti në bar për të paguar për vajzat që i kishim kërkuar dhe sa më kujtohet mua ai më tregoi se kishte paguar 300 Euro" kjo është ajo që keni thënë në deklaratën e juaj.

: Keto fjalë që i lexuat Prokuror.

Gjykatesi nderkombetar: Nuk jeni lejuar për të bërë këtë, vetëm përgjigjuni pyetjeve.

: Une nuk i kam thënë keto fjalë.

Gjykatesi vendor: "Në nuk i kemi zgjedhur këtë vajzë edhe pse, pastaj shkuam në Adora....." pyetja ishte "a keni paguar diç". Përgjigja ishte "Nuk e di, ata nuk më kanë pyetur për letërnjoftim". A ke shkuar në Hotel Adora apo jo?

: Une nuk isha atje.

Gjykatesi vendor: Ju keni thënë se keni qëndruar në Adora deri në orën 01.35.

: Une këtë nuk e kam thënë.

Gjykatesi vendor: A e keni dhënë deklaratën në gjuhën shqipe?

: Po, në gjuhën shqipe.

Gjykatesi vendor: A keni ndëgjuar se cka shkruhej në procesverbal?

: Ndryshe është cka thua dhe cka shkruhet.

Gjykatesi vendor: Pra, procesverbali ndryshon?

: Po, nuk është identik me atë cka kam thënë.

Gjykatesi vendor: A e keni mbajte ne dore proqesverbalin per te nenshkruar?

..... : Po, Jam ngrite dha kam shkruar te tavolina dhe e kam nenshkruar. Ne fakt nuk e kam mbajte ate ne dore dhe nuk me eshte dhene aty ku isha i ulur.

Gjykatesi vendor: A te ka ndaluar ndonjeri qe te lexosh ate?

..... : Nuk me ka shkue ndermend te lexoja ate qe kisha thene.

1. f) ne deklaraten e tij te dhene para kolegjit ka deklaruar se kishte shkuar ne Macuba me shokun e tij per te pire.. Ata ishin sherbyer nga nje grua me te cilen ai bisedoi, mirepo nuk i kujtohej se cfare kishte ndodhur me vone meqe ai ishte dehe. Pas tri diteve ai shkoi vetem atje perseri dhe bisedoi me te njejten grua, ata shkuan ne qytet dhe me vone ne nje hotel, ajo kerkoi te holla nga ai dhe ai i dha asaj te holla. Nje jave pasi qe ia kishte dhene deklaraten prokurorit, dikush e thirri me telefon dhe e kercenoi lidhur me rastin Thaqi.

Nga deklarata e dhene policise nga deshmitari gjate hetimeve, duket se ai kishte shkuar ne Makuba ne heren e pare me 6.11.2007 se bashku me dhe hera e dyte ishte dhjete dite me vone.

Gjate ekzaminimit deshmitari u konfrontua shume here me deklaraten e tij qe ia kishte dhene policise (proqesverbali i dates 4.2.2009):

Gjykatesi vendor: *Ku ke shkua me kete vajze?*

..... : *Kemi shkuar ne qytet e pastaj ne nje hotel; nuk e di se ne cilin hotel.*

Gjykatesi vendor: *Ku eshte ky hotel?*

..... : *Nuk e di.*

Gjykatesi vendor: *Ne heren e pare apo te dyten?*

..... : *Ne heren e dyte.*

Gjykatesi vendor: *Kush e pagoi hotelin?*

..... : *Une vet.*

Gjykatesi vendor: *Je keni dhene nje deklarate tjeter apo deshironi qe t'ua perkujtoj ate?*

..... : *Nuk e di.*

Gjykatesi vendor: *Une ia dhash 200 Euro dhe ajo me tha te shkonim ne Hotelin Adora dhe kur shkova ne hotel i informova se kisha ardhe nga Makuba dhe recepcionisti m'i dhe qelesat dhe nuk i kam paguar te hollat ne hotel. Kush e rezervoji dhomen? Pergjigjeja: Pronaret e Makubes. A eshte e vertete?*

..... : Jo. Une isha ne hotel se bashku me vajzen.

Gjykatesi vendor: I keni treguar Prokurorit Publik se vajza eshte dashur te pyeste padronin e saj per leje. A eshte e vertete?

..... : Jo, ajo me thirri.

Gjykatesi vendor: Ju e keni identifikuar padronin nga fotografia dhe keni thene se ai eshte Sadik Thaqi. A eshte e vertete?

..... : Jo.

Gjykatesi vendor: A ju kercenuar dikush pasi qe ia keni dhene deklaraten Prokurorit Publik?

..... : Jo.

Gjykatesi vendor: : Nje jave pas dhenies se deklarates prokurorit Publik dikush me thirri ne oren 19.20 pa numer te telefonit dhe me tha se ajo qe keni deklaruar dhe cka keni thene lidhur me ca njerez ju nuk keni asnje zgjidhje tjeter, ju ose do te ktheheni andej nga keni ar dhe ose. A ju ka kercenua ndonjeri nepermes telefonit?

..... : Po.

Gjykatesi vendor: A e dini se kush ju ka kercenua?

..... : Jo.

...

Gjykatesi nderkombetar: A mund t'i spjegoni kolegjit, se pse ekzistojne aq shume dallime ne mes te deklaratave te mehereshme dhe kesaj qe jeni duke na dhene? Sepse para Prokurorit Publik keni deklaruar ne heren e dyte, para se te shkonit me vajzen, keni kerkuar leje nga padroni i saj. Pse po e mohoni kete?

Ju e dini se jeni te obliguar te tregoni te verteten dhe poashtu dini se genjimi eshte veper penale. A ju kujtohet me mire me heret apo po ju kujtohet tash me mire?

..... Shikoni, cka me kujtohet dhe di tash; ne ate bar kam qene dy here, ne heren e pare bashke me shokun tim kurse ne heren e dyte isha vetem.

Gjykatesi nderkombetar: Pra, nuk po ju kujtohet se a keni pyet per leje me dale bashke me vajzen?

..... : Nuk me kujtohet.

Gjykatesi nderkombetar: Pra nuk po ju kujtohet.

..... Nuk me kujtohet sepse nuk kam biseduar me padronin.

Gjykatesi nderkombetar: Eshte nje gje te thuash se nuk te kujtohet se cfare kishte ndodhur dhe eshte tjeter te thuash se ajo gje specifikke nuk ka ndodhur. Pra, po ju pyes prap, a po ju kujtohet apo jo?

..... Jo.

Gjykatesi nderkombetar: Kur u moret ne pyetje para Prokurorit Publik ju kujtohej shume me mire se tash dhe keni thene se para se te dilnit me vajzen, po e lexoj, jam ne faqen 3, dhene Prokurorot Publik me 21 prill, me pyeten se mos donte ajo te vinte me mua dhe ajo tha se ajo duhej te kerkonte leje nga padroni i saj lidhur me ate.

..... : Ajo ka folur me padronin e saj; une nuk kam folur me padronin e saj.

Gjykatesi nderkombetar: Une po them se ju i keni thene Prokurorit Publik se e kishte pyet padronin e saj.

..... Per t'i qartësuar gjerat, une kam fole drejtpersedrejt me vajzen dhe nuk di per padronin.

Gjykatesi nderkombetare: Nuk e dini apo nuk ju kujtohet?

..... : Nuk e di.

Gjykatesi nderkombetar: Po ju ballafaqoj me Nenin 364 sepse ne kete deklarate ju keni thene se ajo duhej te pyeste padronin e saj.

A eshte e qarte se cfare i keni deklaruar Prokurorit Publik?

..... Po i perseris te gjitha informatat qe gjinden ne deklaraten time: Une kam shkuar atje dy here.

Gjykatesi nderkombetar: Kjo nuk ishte pyetja ime; une po them se ju keni thene gjera te ndryshme ne deklaraten e juaj te mehereshme.

..... : Nuk e di se a e ka pyet ajo padronin.

Gjykatesi nderkombetar: Pse, pra i keni thene Prokurorit publik, se ajo e kishte pyet padronin e saj?

..... : Nuk e di qe e kam thene ate.

Gjykatesi nderkombetar: A eshte e mundur qe ju kujtohet me mire para Prokurorit Publik se tani?

: Po me kujtohet me mire tash.

Kryetari i kolegjit: Nuk eshte e vertete sepse para Prokurorit Publik keni thene se kjo vajze kishte kerkuar leje nga padroni i saj kurse tani po thoni se nuk po ju kujtohet. Keto jane dy gjera te ndryshme.

: Nuk e di se a e ka pyet padronin e saj apo jo.

Kryetari i kolegjit: Ne kete moment pergjigjeja e juaj eshte se tash nuk e di se ajo qe keni thene para Prokurorit Publik dhe ajo qe jeni duke thene tash jane te njejta. Ato nuk jane te njejta. Dy deklaratat jane te njejta.

Une mund te them se une isha aty ne bar. Jam pyetur nga policia dhe Prokurori Publik dhe jam pergjegje, kete mund te beje edhe ketu sot. Une nuk e kam shkryar deklaraten.

Gjykatesi nderkombetar: Para se te dilnit per here te dyte me ate vajzen a i keni derguar dikujt ndonje mesazh?

: Ajo gruaja me dha nje thirrje te humbur dhe une ia dergova nje mesazh.

Gjykatesi nderkombetar: Po ju ballafaqoj me deklaraten e mehershme ne faqen 3, te cilen ia keni dhene Prokurorit Publik me 21 prill 2007: para se te shkonit atje, une ua dergova nje mesazh ne numrin 585 765 te cilin e mora nga kurse ky numer te cilit i shkorova nuk me eshte pergjegje. A po e mohoni edhe kete rrethane?

: Po. Une kam derguar kete sms.

Gjykatesi nderkombetar: A ua ka dhene kete numer?

: Po.

Gjykatesi nderkombetar: Lidhur me kete numer, nuk pres qe t'i dini keta numra permendesh por ate qe ia keni deklaruar prokurorit Publik. A eshte e vertete?

: Nuk me kujtohet se cka i kam thene.

Gjykatesi nderkombetar: Kur e lexova deklaraten e juaj, kur lexova ate qe keni thene. Une jam i interesuar ne numrin te cilit ia keni derguar SMS-in.

: Nuk me kujtohet.

Gjykatesi nderkombetar: Prokurorit Publik i keni thene numrin, tash apo qendroni pran deklarates se juaj apo kete pjese te numrit?

: Nuk po kuptoj.

Gjykatesi nderkombetar: Kur iu pergjigjet Prokurorit Publik, asaj ia keni thene numrin. Pra, ne ate kohe, supozoj se iu eshte kujtuar numri?

: Kur isha para Prokurorit Publik, Prokurori Publik me dha numrin dhe me pyeti nese ai numer me ishte derguar mua kurse une e verifikova telefonin tim dhe e konfirmova.

Gjykatesi nderkombetar: Mire. Pra, keshtu ka shkuar lidhur me kete numer?

: Prokurori Publik ma ka treguar numrin.

Gjykatesi nderkombetar: Une jam duke folur lidhur me heren e pare ne Hotelin Adora. A ishi vetem apo bashke me shokun e juaj . ?

: Nuk me kujtohet. Mendoj se isha ne Makuba bar. Me kujtohet qe pata shkuar ne tualet mirepo me vone nuk me kujtohet asgje perveq zgjimit ne tualet.

Gjykatesi nderkombetar: Prap jam ne faqen 2, kur u larguat nga Makuba, ku shkuat sepse ju keni thene se: u larguam nga Makuba dhe shkuam ne qytet per te pire kafe kurse me tha qe te shkonim ne Xerxe, ne hotelin Adora dhe pastaj do te na sillnin vajza dhe kur shkuam atje recepcionist na i dha qelesat e dhomes dhe rreth ores 01.15 grate kane hyre ne dhomen time.

Tash qe ua freskova memorien, a po ju kujtohet me mire?

: Jo.

Gjykatesi nderkombetar: Pra po mendoni se ate qe e keni thene para Prokurorit Publik ishte e vertete?

: Jam ftuar ketu qe te jap deklaratën. Me kujtohet cdo gje qe kam thene.

Gjykatesi nderkombetar: Pra, ju po ngelni prane tere asaj deklarate qe ia ikeni dhene Prokurorit Publik?

: Po e them prap se atje isha ne heren e pare bashke me shokun tim, dhe kur u zgjova e gjeta veten ne hotel.

Gjykatesi nderkombetar: Ku? Ne Macuba, Adora apo ku? Bashke me .. ?

: Ne Macuba dhe pjesa tjeter nuk me kujtohet.

Gjykatesi nderkombetar: Para Prokurorit Publik keni thene se ishi bashk me [] ne Makuba, a keni genjyer apo keni treguar te verteten?

[]: Nuk me kujtohet.

Gjykatesi nderkombetar: Cka nuk ju kujtohet, se e keni thene te verteten?

[]: Nuk me kujtohet.

Gjykatesi nderkombetar: Une mund t'ju tregoj se cka keni thene para prokurorit Publik. Keni deklaruar se ishi bashk me shokun e juaj [] ne hotelin Adora. A e keni treguar te verteten apo jo?

[]: Jo.

Gjykatesi nderkombetar: Jo, cka?

[]: Nuk e kam thene te verteten.

Gjykatesi nderkombetar: Pra, keni genjyer para Prokurorit Publik?

[]: Nuk e di dhe nuk me kujtohet.

1.g) [], ne deklaraten e tij te dhene para kolegjit, ka thene se ne ate nate ishte ne Hotelin Pashtrik gjate mbremjes dhe me vone kishte shkuar ne ate klub rastesisht. Brenda kishte kamariere qe sherbenin dhe atij i pelqeu njera dhe e pyeti njerin nga vajzat se a do te mund te kalonte naten me ate vajzen qe e pelqente. Ati i thane se do te duhej te paguante 100 Euro per ate grua dhe ai u pajtua. Ai ia dha te hollat baristit dhe i thane qe te shkonte ne hotel ke ajo vajza per te cilen kishte dhene te hollat. Ai shkoi ne Hotelin Amsterdam dhe priti deri sa erdhi vajza dhe pat seks me te. Ai pagoi 30 Euro per hotel, mirepo nuk la asnje dokument, meqe nuk kishte asnje dokument me vete. Gjate ekzaminimit e njohu [] si ajo vajza te cilen e kishte paguar per sherbimin seksual (proqesverbali i dates 19.02.04, faqja 4). Nga deklarata e dhene policise gjate hetimeve, rezulton se ai kishte shkuar ne klub me 31.01.2007.

2. Deklaratat, raportet e policise dhe provat tjera dokumentare qe u lexuan gjate seancave gjyqesore.

2.a) Provat dokumentare dhe raportet.

Gjate gjykimit kryesor, dokumentet ne vijim u lexuan ne cilesine e provave:

- Raporti qe kishte te bente me tekstet e mesazheve;

- Raporti mjekesor nr. 1059, i dates 31.01.2008 e
- Te dhenat e emerave te klienteve ne Motelin Adora nga data 01.01.2008 deri me 31.01.2008;
- Certifikata e konfiskimit te perkohshem e gjerave te sadik Thaqit te dates 31.01.2008;
- Certifikata e konfiskimit te perkohshem e gjerave te te dates 31.01.2008;
- Certifikata e konfiskimit te perkohshem e gjerave te te dates 31.01.2008;
- Transkriptimi i pergjimeve te mara nga CD-ja e bashkangjitur ne dosjen e rastit;
- Memorandumi i brendshem i dates 19.12.2007;
- Informata mbi tranzakcionet e Western Unionit e bera ne Zyren e Financial Union ne Prishtine te dates 29.02.2008, n. 84;
- Proqesverbali i bastisjes se nje banese dhe te personave te dates 31.01.2008;
- Diagrami i transfereve te ndryshme te te hollave te gatshme;
- Certifikata e Regjistrimit e Restaurantit Macuba, te dates 17.10.2005;
- Te dhenat e regjistrimit te nje kompanie afariste individuale te dates 29.10.2003;
- Te dhenat e nje regjistrimi te ri te nje kompanie afariste individuale te dates 29.10.2003;
- Autorizimi i avokatit te dates 11.03.2004;
- Autorizimi i avokatit te dates 13.11.2003;
- Kontraktet e punesimit;
- Raport i permbledhur te dates 6.5.2008 lidhur me hetimet financiare;
- Raporti kriminal te dates 2.2.2008;
- Memorandumi i brendshem te dates 16.8.2007;

2.b) Deklaratat e paleve te demtuara dhe te deshmitareve

Ne pajtim me KPPK-ne, Neni 368, par.1, nenpar.1, deklaratat ne vijim jane lexuar ne cilesine e provave gjate gjykimit kryesor, meqenese paraqitja e deshmitareve ne gjykate ishte e pamundshme. Ne fakt, sa i perket paleve te demtuara, adresat e tyre te tanishme ishin te panjohura kurse sa i perket deshmitarit i raporti i policise njoftonte se ai momentalisht ishte duke punuar diku ne Iran ne cilesine e futbollistit profesionist.

Deklarata e dhene Prokurorit me 04.03.2008.

Ajo deklaroi se ajo kishte ardhe ne Kosove ne qershor te vitit 2004 dhe se ishte e ftuar nga nje shoqe e quajtur e cila atehere ishte ne kosove. Vajza e quajtur ishte ajo qe ia kishte spjeguar mariaz punen qe ajo duhej te bente ne klubin "Alaska". Kontrata e punes iu ishte derguar asaj nepermes nga ana e menaxherit te klubit. Ne kontrate ishte theksuar lloji i punes (kamariere), me nje mroge mujore prej (150 eurove plus bakshishi nga pijet). Punedhenesi, sipas kontrates, ishte Lulzim Thaqi. Ajo u prit nga Lulzim Thaqi ne aeroport kur ajo arriti ne Kosove dhe shkuan menjehere ne barin Alaska. Ajo punonte si valletare e striptizit ne bar dhe orari i saj i punes ishte

nga 19.00 deri me 00.00, pas se ciles ishte e lire dhe Lulzimi nuk i kishte thene asnjehere qe te ofronte sherbime seksuale klienteve. Ne bar, perveq Lulzimit qe ishte pronari, ishte edhe Shqiprim Uka qe punonte si barist dhe vajzat tjera qe punonin gjate dites si kamariere kurse si valletare te striptizit gjate nates.

Ajo i dergonte te holla motres se saj) , vellaut te saj dhe shoqes se saj ne Moldavi, mirepo ajo mohoi se kishte derguar nje shume prej 7500 Eurove.

Gjate punes se saj ne bar, ajo shihej me nje person nga Tirana qe quhej . Ajo u njohtua me te ne barin Macuba atehere kur ai udhëhoqej nga sadik Thaqi. Ajo shoqërohej me te pas orarit te punes dhe nuk ishte e obliguar qe ta pyeste padronin e saj per leje. Ajo nuk ishte kercenuar, frikesuar ose forcuar qe te bente dic kunder deshires se saj asnjehere; poqese e pyeste padronin e saj per te shkuar ne qytet ajo e bente kete ne shenj te repektit.

Deklarata e dhene Prokurorit me 22.02.2008

Ajo deklaroi se kishte ardhe ne Kosove me 28.11.2005, nepermes mbiemerin e te ciles nuk e dinte. Ajo u njohtua me te deri sa ajo e vizitonte babain e saj, meqe ai ishte prift dhe ajo konsultohet me te. Ajo i ofroi asaj me shkue ose ne Qipro ose ne Kosove. Asaj i tha se ajo do te punonte ne nje restuarant te quajtur VALA, dhe se orari i punes do te ishte prej ores 10.00 deri 17.00 dhe rroga e saj do te ishte perqindja nga pijet e konzumuara nga klientet. Ne kontraten e punes te cilen ajo e mori me faks ne Moldavi shkruante se rroga e saj ishte 250 Euro.

Kur ajo arriti ne Kosove, Sadiku dhe nje person tjetër qe e voziste veturen e prisnin ne aeroport dhe shkuan menjehere ne restaurantin VALA. Gjate punes se saj aty, sadiku ishte pronari dhe kishte poashtu edhe punetore te sigurimit, baristi dhe nja 8-10 vajza.

Ajo deklaroi se ajo u njohtua me Lulzimin kur filloi te shihej me Shqiprimin, pasi qe ata ishin familjar. Gjate punes se saj ne klub ajo ishte e lire vetem dy ore ne dite, te cilat zakonisht i perdorete per blerje dhe nje here ne jave, ata mund te shkonin kudo qe ajo deshironte, poashtu edhe jashte qytetit. Asaj nuk iu eshte thene asnjehere qe te ofronte klienteve sherbime seksuale. Me nje rast, ajo e pyeti sadikun nese ajo do te mund te dilte me nje person te quajtur dhe asaj iu lejua meqe ky person shpenzonte shume para ne kete bar dhe ajo do te kishte nje profit.

Ajo shkante ne Hotel Adora dhe Evropa me . Ata shkonin atje me taksi, ndonjehere sadiku do t'i qonte atje me veturen e tij e ndonjehere me veturen e . Atehere kur i voziste sadiku, ai do te kthehej me vone per t'i marre. Ndonjehere shkonin 2-3 vajza me kete person sepse atij i pelqente qe te shpenzonte te holla, kurse Sadiku i voziste per ne hotel.

Ne bar ishte Shqiprimi qe i ndihmonte Sadikut per te organizuar punen, poashtu edhe dhe , te cilat i mbanin te hollat.

Kur ajo shkoi ne Moldavi, Shqiprimi i dergoi te holla per shpenzimet e rruges.

Ajo ishte plotesisht e lire me shkue me kendoqofte dhe ndonjehere ajo do e pyeste Sadikun se ku do te mund t'i blente kondomet per t'u mbrojtur. Ajo dilte me njerez tjereper te bere Shqiprimin xheloz si dhe per kenaqesine e saj, mirepo ate askush nuk e detyronte.

Deklarata e _____, dhene Prokurorit me 22.02.2008.

Ajo deklaroi se ajo kishte ardhë në Kosovë para kater vjeteve. Ajo e kishte pyet një shoqe te saj te quajtur _____ se a do te mund te vinte ne Kosove kurse ajo e pyeti padronin e saj, i cili tha se ajo do te mund te vinte nese i pelqente. Kontrata iu dergua asaj nepermes faksit vetem per ate per te lexuar, mirepo ajo nuk ishte e nenshkruar dhe kur arriti ne Kosove ajo kuptoi se padroni i saj ishte Lulzimi.

Në fillim ajo ka punuar si kamariere e pastaj ka filluar të punojë edhe si vallëzuese. Ajo ka punuar deri në ora 12:00 mesditë dhe pastaj ishte e lirë të bëjë çfarë të dojë, porse është dashur ta informojë shefin e saj se a do të vonohej dhe ku do të shkonte, por vetëm për arsye të sigurisë.

Kur ka filluar të punojë, shef i saj ishte Lulzimi dhe emri i restorantit ishte Vala kurse emri i kafe-barit ishte Alaska. Më vonë Lulzimi e ka pyetur atë se mos kishte dëshirë të punojë në një bar tjetër dhe të kishte një shef tjetër apo mos kishte dëshirë të shkojë në shtëpi në Moldavi. Ajo u pajtua që ta ndërrojë shefin, e pastaj bari u quajt Makuba, ato i morën kontratat e reja kurse shef i ri u bë Sadiku, pastaj Lulzimi rrallë e ka vizituar klubin, vetëm kur dikush prej tyre kishte ditëlindje apo ndonjë rast tjetër.

Kur dilte me dikënd ata i jepnin para asaj, ata e bënin këtë që t'i ndihmojnë asaj dhe jo t'ia paguajnë asaj. Ajo gjithashtu ishte e lirë të dalë apo të shkojë në Moldavi sa herë që dëshironte.

Deklarata e _____ e dhënë para prokurorit më 04.03.2008.

Ajo deklaroi se kishte ardhë në Kosovë në mars 2006 të punojë si kamariere, e ftuar nga motra e saj i cila veç ishte në Kosovë. Kur ajo arriti në Aeroportin e Prishtinës, atë po e prisnin Sadiku dhe _____

Në klubin ku ajo punonte, aty gjindej edhe Shqiprimi i cili po punonte si barmen. Ajo e njihnte Lulzimin nëpërmes vajzave tjera të cilat thonin se ai do të bëhej në të ardhmen shef i barit. Në bar ajo pinte dhe ulej me mysafirë, pas orës 12 të mesditës, ishte e lirë të dalë me mysafirë nëse donte.

Ajo jetonte në barin ku punonte, por, në disa raste, ka ndodhur se ajo ka fjetur në hotel dhe se kur e bënte këtë, ajo e informonte Sadikun vetëm sa për respekt, porse nuk ishte e detyruar ta bëjë një gjë të tillë.

Kur ajo u arrestua, ajo ishte në Hotelin Adora. Ajo ka shkuar atje me taksì, përderisa shoqja e saj _____ dhe i dashuri i saj, së bashku më një shok tjetër, emrin e të cilit ajo nuk e dinte, po e prisnin atë.

Vërejtja e saj ishte se nuk e konsideronte veten viktimë.

Deklaratat e dhënë policisë dhe prokurorit më 29.04.2008.

Në dhjetor 2007, ai ishte në Gjakovë të nënshkruajë kontratë me ekipin e futbollit "Vllaznini". Pas nënshkrimit të kontratës, ai shkoi në klubin Macuba me shokun e tij dhe vëllain e kryetarit të ekipit të futbollit, , i cili, pasi foli me një person në bar, iu tha atyre se nëse dëshironin ndonjë vajzë, mund t'i mirmin. zgjodhi përderisa zgjodhi një vajzë tjetër e pastaj u tha atyre të shkojnë në hotelin Adora e t'i presin vajzat atje. Ata shkuan në hotel dhe vajzat arritën për afërsisht në ora 00:30, porse ai nuk e ka parë se kush i mori ato. Ai pati marrëdhënje seksuale me olgën dhe të nesërmen në mengjez, në ora 07:15, ajo u largua prej hotelit. Herën tjetër ai shkoi atje me një shok tjetër i quajtur dhe i kërkoi shefit të barit që të bënte seks me Ai u përgjigj se nuk ka problem porse duhej të paguante 120 Euro. Kur ai i pagoi të hollat, shefi i tha atij të shkojë në hotel Adora dhe ta presë vajzën atje. shoi në hotel, pagoi dhomën dhe, pas një kohe, arriti

Dëshmitari dha një deklaratë të dytë para prokurorit duke e përsëritur të njëjtin version të cilin e kishte deklaruar në polici. Përveç kësaj, atij iu kërkua që ta identifikojë Lulzim Thaqin, Sadik Thaqin dhe Shqiprim Ukën në fotografi, porse ai nuk mundi t'i identifikojë ata.

2. c) Deklaratat e të pandehurve të cilat u lexuan

- Deklarata e të pandehurit Shqiprim Uka dhënë në polici, e datës 01.02.2008

Në deklaratën e tij, i pandehuri pohoi se në vitin 2005, një ditë pasi Lulzim Thaqi ishte liruar prej burgut, ky i fundit atij i kishte ofruar një punë; oferta ishte për një punë si barmen në Klubin Alaska, për një pagë prej 200 eurove dhe me orar pune prej 12:00 deri në 00:00. Ai u pajtua dhe filloi të punojë më 25.06.2005; gjithashtu Sadiku po punonte në klub dhe se ai shumicën e kohës rrinte në bar dhe se aty përkujdesej. Pastaj, 2 apo 3 muaj më vonë, emri i barit u ndërrua nga Alaska në Macuba. Kur ky filloi yë punojë, aty gjindeshin 14 vajza nga Moldavia në punë, të moshës prej 21-25. Disa prej vajzave punonin si vallzuese nëpër shtylla të metalta kurse disa tjera si kamariere. Vallëzueset vallëzonin me rroba të brendshme. Disa prej vajzave punonin në restorant gjatë ditës deri në ora 16:00 dhe pas orës 19:00 gjitha ato shkonin poshtë në klub dhe punonin aty. Ai punoi aty më shumë se një vit e gjysmë dhe fitonte 50 euro në javë.

Vajzat që punonin për Lulzimin dhe Sadikun ishin të lira të dalin sa herë që donin, porse disa vajza kishin kufizime sepse atyre iu ndodhte të pihen dhe të krijojnë problem në qytet. Ai deklaroi se nuk ishte në dijeni se vajzat detyroheshin me dhunë të kenë marrëdhënje seksuale me klientë, por theksoi se disa prej vajzave i kishin të dashurit e tyre.

Ai tha se Sadiku ia kishte kërkuar njëherë atij ID-në në mënyrë që t'ia dërgojë disa para në Moldavi dhe se kur ia kishte kthyer ID atij, Sadiku i kishte thënë se i kishte dërguar 500 Euro. Me një rast tjetër, Shqiprimi i kishte dërguar para të dashurës së tij në shumën prej 500 Eurove. Ai ka mohuar t'i ketë dërguar tri herë para në shumën prej 2000 Eurove më 18.08.2007, shumën 500 Eurove më

31.08.2007 dhe një shumë tjetër prej 1500 Eurove më 22.09.2007, kur policia e ballafaqoi me këtë çështje.

Gjatë kohës derisa ka punuar në Makuba, pronar ishte Sadiku, por kur Sadiku nuk ishte aty, ai i kërkonte Lulzimit leje nëse donte të shkojë për pije apo në shtëpi.

Sa i përket mesazhit të dërguar në telefonin e tij më 27.8.2007 *"I kam marrë paratë prej tyre. 100 per. Rezervoji dhomat. Ok duhet ta paguash hotelin"*, ai e ka mohuar të ketë dërguar një mesazh të tillë meqë nuk ka guxuar të flasë për këto gjëra, meqenëse Sadiku i kishte thënë se e kishte punën e vet me të cilën të mirret.

Përmëtej, në intervistë policia e kishte pyetur lidhur me disa tekste të mesazheve të cilat ia kishte dërguar në të cilat ai e kishte pyetur të një pyetje: *'kush është klienti i juaj?'* I pandehuri është përgjigjur se me fjalën *"klient"* ai ka nënkuptuar mysafirin i cili e ka pyetur vajzën të ulet me të dhe paguan 100 euro apo 200 Euro për pijet dhe se, nëse vajza dëshiron, ata mund të shkonin prej klubit dhe të shkojnë në hotel.

- Deklarata e të akuzuarit Shqiprim Uka dhënë në zyren e prokurorit më 31.03.2008

Në deklaratën e tij, i pandehuri pohoi se kishte filluar të punojë në Makuba si barmen, dy vite e gjysmë më parë; menaxher i klubit të natës ishte Sadik Thaqi. Ai ka punuar në dy ndërrime, nga 12:00 deri 17:00 dhe nga 19:00 deri 00:00 për një rrogë prej 200 Eurove. Ai kishte punuar aty vetëm Sadikun, përderisa Lulzimi e vizitonte barin vetëm si mysafir, më shpesh gjatë natës. Sipas Shqiprim, prona ku gjindej bari ishte pronë a babait të Lulzimit, Sahit Thaqit, përderisa firma ishte në emër të Sadikut.

Në klub, numri i vajzave që punonin aty ishte prej 6, 8 deri 14. Vajzat duhej ta informonin Lulzimin dhe Sadikun të dilnin kur donin, meqenëse më herët kur kishin dalur jashtë ato kishin bërë probleme, ishin pirë dhe nuk ishin kthyer 2 apo 3 ditë.

E dashura e tij ishte _____ të cilën ai ia kishte sjellur Sadikut në Kosovë në vitin 2006, dhe ia kishte paguar bielten e rrugës në një shumë prej 700 Eurove. Ai gjithashtu i kishte dërguar shpesh të holla në Moldovë të dashurës së Lulzimit _____ nëpërmes Western Union-it, me kërkesë të Lulzimit. Shumën e parave të cilën ai e dërgont ishte e ndryshme prej 500 Eurove, 200 Eurove dhe 2000 Eurove. Ai e ka pranuar se ishte pronar i telefonit Nokia numri i të cilit ishte 044 432 235.

Ai i kërkonte leje Lulzimit nëse dëshironte ta pijë ndonjë birrë, meqë ai është daja i tij dhe përkujdesej për të.

Në pyetje të tjera ai e përdori të drejtën e tij të mbetet në heshtje.

- Deklarata e Sadik Thaqit dhënë në zyren e prokurorit më 14.03.2008

I pandehuri deklaroi se e kishte hapur restorantin me emrin Macuba në vitin 2005. Restorantin e kishte marrë përsipër nga djali i vëllait të tij Lulzim Thaqit.

Në vitin 2003 ai e kishte një restorant tjetër me emrin *"Arditi"*. Ai e paguante qiranë 300 euro në muaj për barin Macuba. Në bar së bashku me të ishin Shqiprim Uka dhe _____ të cilët punonin si barmen si dhe gjashtë femra të punësuar. Pothuajse të gjitha gratë që punonin në klubin e tij gjindeshin në Kosovë, përveç _____ dhe _____ të cilat kanë ardhur mbasi që ky e kishte marrë përsipër klubin. _____ dhe _____

kanë ardhur në Kosovë nëpërmes tij, meqenëse motra e ishte duke punuar në Kosovë dhe se e informonin njëra tjetrën. Ai i ka dërguar kontratat për to nëpërmjet faxit për në Moldovë, sipas të cilit rroga mujore ishte 150 Euro për punën si kamarierë dhe vallëzuese. Shpenzimet e udhëtimit i mbulonte ai në shumën prej 500-600 Euro për secilën biletë. Në aeroport, ai i ka pritur vajzat.

Shumë mysafirë vizitonin barin, kryesisht në mbrëmje. Kur ata dëshironin, ata mund të kërkonin që disa prej vajzave të vallëzojnë. Në bar, ai vetëm kontrollonte situatën e furnizonte barin dhe shkonte me vajza nëpër klube.

Ai i paguante vajzat me kesh menjëherë apo më vonë dhe përkujdesej për të holla. Gjatë ditës, kamarieret i mbanin paratë, por në mbrëmje ia jepnin paratë atij së bashku me regjistrin. Vajzat ishin të lira të dalin prej klubit, por gjatë orarit të punës, atyre iu duhej ta pyesnin atë për leje. Por gjithashtu kur ato dëshironin të shkonin për kafe apo tek frizeri, ata duheshin ta informonin Sadikun.

Ai ka pranuar se në disa raste, Lulzimi kishte dërguar para në emër të tij në Moldavi, por askush tjetër që punonte në bar nuk e kishte bërë këtë.

Ai e ka mohuar të ketë dërguar gra në hotele për shërbime seksuale.

Ai e ka pranuar se e kishte numrin 044 386 666. I ballafaquar nga prokurori lidhur me tekstin e mesazhit të dërguar nëpërmes numrit të tij më 25.06.2007 në ora 00:03, ("*..... është me një klient në Amsterdam. Paratë janë tek*"), atij nuk i kujtohej mesazhi.

Mëtej, ai ballafaqua edhe me një mesazh tjetër të dërguar më 28.07.2007 nga numri 044 432 235 i cili ishte i Shqiprim Ukës ("*I mora paratë nga ata, 100 secili, rezervoi dhomat dhe ju do ta paguani hotelin*") por ky e ka refuzuar të ketë marrë këtë mesazh.

Përsëri ky u ballafaqua nga ana e prokurorit lidhur me një mesazh që i është dërguar këtij ("*Nëse është e lirë, sille atë tek hotel Adora. Rrugës kah të kthehem prej Prizrenit, do ta pres atë. Kur të mbërrij atje, ma bëj me dije*"). por ky e ka refuzuar të ketë marrë këtë mesazh.

I pandehuri gjithashtu deklaroi se, gjatë kohës kur ai po e menaxhonte barin, ai kishte dërguar para në Moldavi vetëm atyre grave të cilat kishin punuar për atë në bar. Ai gjithashtu shtoi se të gjithë të punësuarit në barin e tij kishin kontratë pune.

2. Deklaratat e të akuzuarve dhënë para trupit gjykues

Në gjykimin kryesor, dy prej të pandehurve, konkretisht Lulzimi Thaqi dhe Ali Xerxa i kanë dhënë deklaratat e tyre, përderisa dy të tjerët, Sadik Thaqi dhe Shqiprim Uka e kanë ushtruar të drejtën e tyre për të mbetur në heshtje, kështu që deklaratat e tyre të mëhershme janë lexuar.

1. Lulzimi Thaqi e ka dhënë deklaratën e tij para gjykatës më 24 shkurt 2009. Ai ka deklaruar se e kishte filluar biznesin e tij në vitin 2003, kur e kishte hapur Restorantin Vala së bashku me të dashurën e tij plus me një shok dhe motër të këtij të fundit, kurse vëllai i tij e kishte hapur klubin Alaska. Mbasi që vëllai i tij kishte vdekur prej një sulmi në zemër, ai e mori përsipër klubin. Një vit pas, i ishte dashur t'i kalojë katër muaj në burg për shkak se i kishte thyer rregullat e trafikut, pas kësaj ai e kishte mbyllur klubin. Vajzat që po punonin aty, kishin shprehur dëshirën të punonin tek

mixha i tij Sadiku, në klubin e quajtur Macuba. Ky e ka pranuar se ka dërguar të holla në Moldavi, por e kishte bërë këtë meqë vajzat e kishin kërkuar atij të veprojnë ashtu, sepse ato kishin frikë të marrin me vete shuma të mëdha të hollash me veti kur udhëtonin për në Moldavi.

Gjithashtu e ka mohuar të ketë kryer veprimtarinë e furnizuesit.

Gjatë ekzaminimit, prokurori e ka ballafaquar me faktin se e kishte bërë pagesën e shpenzimeve për të gjitha gratë të cilat kishin punuar për të dhe se shpesh kishte bërë rezervimin e dhomave në hotelin Amsterdam (procesverbali i 24.02.09).

Prokurori publik: Kush ishte në aeroport duke i pritur vajzat?

Lulzim Thaqi: Për të cilën kohë e keni fjalën?

Prokurori publik: Për kohën kur ju ishit pronar i Alaskës.

Lulzim Thaqi: Ngadonjëherë, unë kam shkuar atje ti pres. Tjerave herë, vetë vajzat kanë shkuar ti presin motrat e tyre apo kushërirat.

Prokurori publik: Kush ua ka paguar rrugën atyre?

Lulzim Thaqi: Ngadonjëherë unë e kam bërë pagesën, por gjithashtu edhe ato kanë paguar për motrat e tyre, të afërmit e tyre dhe kushërirat.

Prokurori publik: Pse më herët keni thënë se të gjitha vajzat që kanë punuar për ju, pse më herët keni thënë se “unë e kam bërë pagesën për të gjitha udhëtimet të cilat i kanë bërë vajzat”? Po citoj “për të gjitha vajzat i kam paguar shpenzimet e rrugës”

Gjykatësi kryesues: A mund të na thuani datën e asaj deklaratë?

Prokurori publik: 31 janar 2008, në polici.

Gjykatësi kryesues: A e keni lexuar deklaratën?

Prokurori publik: Po.

Lulzim Thaqi: Nuk e di se sa bileta i kam paguar, por nuk është e vërtetë se i kam paguar të gjitha biletat.

.....

Prokurori publik: A keni rezervuar ndonjëherë ndonjë dhomë?

Lulzim Thaqi: Ka mund të ndodhë njëherë apo dyherë kur kam shkuar me ndonjë shok timin dhe përsëri për veten dhe për shokun tim.

Prokurori publik: A keni qenë, a keni shkuar, shpesh në atë vend? Apo a keni bërë ndonjë rezervim?

Lulzim Thaqi: 3 apo 4 herë, maksimum 4 herë.

Prokurori publik: Nëse po thuani 2 apo 3 herë, a po ju kujtohen datat?

Lulzim Thaqi: Nuk më kujtohen datat.

Prokurori publik: Rezervimet e regjistruara në hotelin Dora, kemi dëshmi për një numër të konsiderueshëm të rezervimeve që ju i keni bërë.

Lulzim Thaqi: Çfarë të them tani?

Prokurori publik: A i keni bërë rezervimet?

Lulzim Thaqi: Ju thash maksimum tri apo katër herë.

Prokurori publik: Nga dëshmitë e kemi regjistrit, 21 mars 2007. Rezervimi i parë ishte se ju e keni rezervuar dhomën numër 5, a po ju kujtohet?

Lulzim Thaqi: Nuk ka qenë e rezervuar, vetëm kam hyrë në dhomë. Nuk kam mundur të qëndroj në rrugë, isha me të dashurën time.

Prokurori publik: A keni paguar i pari? A ju kujtohet sa?

Lulzim Thaqi: Me sa më kujtohet, dhoma ishte 30 euro por i kemi pasur edhe disa pije kështu që edhe ato i kam paguar.

Prokurori publik: Më 23 mars 2007, dy ditë më vonë, ju e keni rezervuar dhomën numër 2, Më 23 mars 2007, dhomën numër 9. Më 24 korrik 2007 dhe 25 korrik dy dhoma. Më 27 qershor ju keni rezervuar tri dhoma. Numrat e dhomës 7, 11 dhe 9. pse i keni rezervuar tri dhoma për një natë?

Gjykatësi Gianfranco Gallo: Në po të njëjtën ditë?

Prokurori publik: Po.

Lulzim Thaqi: Ka mundur të ndodhë se kam shkuar atje me shokë të mi apo me shokun tim dhe secili prej nesh ka shkuar në dhomë kështu që e kam një shok timin dhe se vajza që ishte këtu para gjyqit atë ditë ajo ka kaluar me shokun tim tri vite rresht, në të gjithë dalim bashkë dhe të gjithë i rezervojmë dhomat së bashku.

Prokurori publik: Ne i kemi tri data, 10 janar 2008, tri dhoma kanë qenë të rezervuara. Dhomat 14, 6 dhe 7. Kështu që sa herë që keni shkuar në motel Dora ju ishit me shokë?

Lulzim Thaqi: I keni tri raste, i keni 3 data, kur unë isha atje me shokët e mi. Secili prej nesh e kishte dhomën e vet, por nuk kam mundur të qëndroj në rrugë, nuk ka mundur ta marr vajzën me vete në shtëpi.

Gjykatësi Gianfranco Gallo: Kush ishin këta shokë, emrat e tyre?

Lulzim Thaqi: Një emër e kam treguar kur po mirresha në pyetje nga Prokurori publik. Nuk e di a është e arsyeshme t'i them emrat tjerë meqenëse ata janë të martuar.

....

I pandehuri gjithashtu u pyet lidhur me numrat e mobilit të tij:

Prokurori publik: Më herët ju gjithashtu u pyetët lidhur me numrat e telefonit gjatë deklaratës juaj në zyrën e prokurorit, dhe ju e keni pranuar se numri i telefonit 044 127 401, 044 829 797 dhe 044 433 394, ju keni pranuar se këta numra kanë qenë numrat e juaj/ a i keni përdorur këta numra?

Lulzim Thaqi: të parin e kam përdorur, 127 401, sepse ishte i imi personalisht. Numri i dytë dhe i tretë ishin numrat telefonik të ndërmarrjes dhe i kam përdorur si edhe punëtorët tjerë.

Prokurori publik: Nga teksti i mesazheve të cilat janë marrë nëpërmjet një urdhëri të gjykatës, këta numra kryesisht ju i keni përdorur. E vërtetë?

Lulzim Thaqi: Ndoshta gjithashtu kur dikush nuk kishte kredit, atëherë ai apo ajo e kërkonte telefonin tim.

Gjykatësi Gianfranco Gallo: "Ai" kush?

Lulzim Thaqi: Ngadonjëherë kur po punoja në treg dikush më ka pyetur dhe ua kam dhënë telefonin atyre.

Gjykatësi Gianfranco Gallo: Edhe gjatë natës gjithashtu?

Lulzim Thaqi: Po.

Gjykatësi Gianfranco Gallo: 24 orë në ditë, nuk paska pasur pushim për ju?

Lulzim Thaqi: Po ka pasur gjithashtu edhe rojtarë. Kur të bëhet ndërrimi gjithmonë njënjë rojtar duhet të jetë i pranishëm.

2. Ali Xerxa e ka dhënë deklaratën e tij më 25 shkurt 2009. Ka deklaruar se ka qenë menaxher i zyrës së Western Union-it në qendër të Gjsakovës, në Hotelin pashtrik dhe se i kishte dy punëtorë. Ka shpjeguar se çfarë ishte procedura për të bërë dërgimin e të hollave jashtë: në veçanti ai ka theksuar se zakonisht nuk është e mundur të dërgohen para

në emër të një personi tjetër, porse disa herë iu ka ndihmuar disa njerëzve të cilët i ka njohur shumë mirë, duke u huazuar atyre të holla që do të transferoheshin. Në disa raste, këtë e kishte bërë për Lulzim Thaqin, porse kurr nuk e ka bërë transferin e të hollave nëse dërguesi i të hollave nuk ka qenë i pranishëm.

4. Dokumente shtesë të cilat palët i kanë parashtruar gjatë seansave të gjykimit kryesor.

Gjatë gjykimit kryesor, me kërkesë të trupit gjykues, prokurori ka parashtruar këto dëshmi të cilat janë përmendur në aktakuzë, porse nuk kanë mundur të mirren nga dosja e lëndës:

1. Raporti mjekësor nr. 1059 e 31.01.08 për
2. Çertifikata e konfiskimit të përkohshëm e Sadik thaqit "gjësendet nr. 2008 DI021 e datës 31.08.08
3. Çertifikata e datës 31.08.08 e gjëseneve përkohësisht të konfiskuara tek i pandehuri.
4. Çertifikata nr. 2008-DI-021 e datës 31.01.08 e gjëseneve të konfiskuara tek
5. Çertifikata nr.2008-DI021 e bastisjes së shtëpisë dhe konfiskimit të kompjuterëve.
6. Regjistrimi i bastisjes së një banese dhe personave i datës 31.01.08
7. Urdhëri për lëshimin i gjëseneve të konfiskuara i datës 14 prill 08
8. Informatat mbi transaksionet financiare të Western Union-it të bëra në zyrën e Unionit financiar në Prishtinë nr. 84m të datës 29.02.08.
9. Shënimet e regjistrimit të ri dhe të amandamenteve të ndërmarrjes afariste solo apo partneritetit publik të datës 19.02.04
10. Autorizimi i avokatit nr. 988 2004 i datës 11.03.04
11. Fotografitë nga faqja 288 deri në faqen 300 të dosjes me etiketën raportet policore.
12. Përkthimet e transkriptit të teksteve të mesazheve
13. Kontratat e punës së grave të cilat punonin në Macuba.

Përmëtej, gjykata *ex officio* ka kërkuar dosjen penale të të pandehurve nga Gjykata e Qarkut në Pejë dhe Gjykata komunale e Gjakovës. Në Gjykatën e Qarkut në Pejë nuk ka

pasur dosje penale kundër të pandehurve, përderisa nga Gjykata komunale e Gjakovës janë marrë këto dokumente:

- Kopja e aktgjykimit të Gjykatës komunale në Gjakovë në lëndën penale P.Nr.650/03 kundër Lulzim Thaqit e datës 07.03.2006.
- Kopja e aktgjykimit të Gjykatës komunale në Gjakovë në lëndën penale P.Nr.256/06 kundër Sadik Thaqit e datës 28.02.2007.

D. VLERËSIMI I DËSHMIVE TË PREZENTUARA

1. Gjetja e fakteve dhe ekzaminimi i provave

Në bazë të dëshmive të cilat janë grumbulluar gjatë hetimeve dhe prezentuar gjatë seansave të gjykimit kryesor, trupi gjykues konsideron se rrjedha e ngjarjeve e cila vijon është dëshmuar pa asnjë dyshim të arsyeshëm.

Nga deklaratat e dhënë nga dëshmitarët të cilët janë dëgjuar gjatë gjykimit kryesor si dhe gjatë fazës së hetimeve, nga thirrjet telefonike dhe tekset e mesazheve të zëna, duket si e pamohueshme se në klubin Makuba, duke filluar nga 2007, gratë ishin marrë për shërbimet seksuale dhe se paratë e dhëna për shërbimet e tyre seksuale ishin marrë nga njerëzit të cilët e menaxhonin klubin.

Nga mesazhet e teksteve si dhe nga deklaratat e Shqiprim Ukës, të dhëna ashtu siç janë lexuar gjatë gjykimit kryesor, del që, bile edhe pse menaxher formal i Makubës ishte Sadik Thaqi, Lulzim Thaqi ishte së paku bashkëpronari, nëse jo pronari i vërtetë, i klubit. Vlen për tu theksuar se bile edhe vet Shqiprimi po e thekson se kur Sadiku nuk ishte i pranishëm ai duhej t'i mirrte Lulzimit leje për të pirë ndonjë birrë apo pwr të dal jashtë klubit.

Deklaratat e dhëna gjatë hetimeve dhe gjykimit kryesor nga qartë tregojnë se klientët e klubit Makuba kanë mundur thjeshtë të marrin gra që punonin brenda klubit për shërbime seksuale. Në veçanti, duhet të thuhet që kur dëshmitarët u ballafaquan me deklaratat e tyre të mëhershme, gjithmonë është parë se deklaratat e dhëna gjatë fazës së hetimeve (ku ata e kanë pranuar se kanë marrë vajza për shërbime seksuale) ishin më të besueshme se ato që janë dhënë gjatë gjykimit kryesor (para trupit gjykues, si duket për shkak të publicitetit të gjykimit kryesor, shumë prej dëshmitarëve dukej ta ndjenin veten keq kur pranonin se kanë pasur seks me prostituta).

Veprimtaria e vërtetë e furnizuesve të cilën e zhvillonin Lulzim Thaqi dhe Sadik Thaqi, në vend të pronarëve të klubit, del në sipërfaqe qartë nga disa tekste të mesazheve ku atyre u kërkohet të gjejnë vajza që japin shërbime seksuale për para. Në disa tjera tekste të mesazheve ata shkëmbejnë informata se a ishin vajzat e zëna apo jo, qartë për t'iu dhënë përgjigje kërkesave të klientëve që kërkonin vajza që japin shërbime seksuale.

Sa i përket individëve që ishin pronar të numrave telefonik, nga deklaratat e të pandehurve të dhëna gjatë gjykimit kryesor si dhe gjatë hetimeve, rezulton se numrat e telefonit të cilët ata i përdornin ishin 044127401, 044829797, 044433 394 (Lulzim Thaqi), 044 386666 (Sadik Thaqi) dhe 044 432 235 (Shqiprim Uka).

I pandehuri Lulzim Thaqi gjithashtu deklaroi gjatë marrjes së tij në pyetje se numrin 044 893 802 e kishte përdorur

Tekstet e mesazheve në vijim janë shembuj të veprimtarisë së furnizuesve të cilën e kanë kryer Lulzim Thaqi dhe Shqiprim Uka:

Data	Origjina	Destinimi	Mesazhi
20/01/2008	44433394	44386666	Mos e le
21/06/2007	44386666	44127401	dhe janë të zëna
25/06/2007	44386666	44127401	është në Hotel Amsterdam Me një klient le të shkojnë tek
28/07/2007	44432235	44386666	I kam marr parat nga ata. 100 per. Reservim te dhomes, Ok, ti do ta paguash hotelin
06/11/2007	44585767	44433394	dhe janë të zanuna
07/01/2008	44371935	44386666	Sadik çka je tue ba, a je mirë, Sadik unë jam ai personi që e kam marr dhe çka ka ndodhë, ai djali më tha një herë se është OK për të dyjat dhe mandej ka thanë se vetëm është e lirë dhe jo, tregom ta di, tung
30/01/2008	44433394	44386666	A është ndonjera prej vajzave e zanun

Mesazhet tjera të cilat qartazi tregojnë se cilët ishin aktivitetet e vërteta që zhvilloheshin në Makuba Club janë si në vijim:

- Mesazhi i 4.3.2007, dërguar në 2.18.37 nga telefoni numër 044 129 388 te telefoni me numër 044 127 401 (Unë jam për këtë unë nuk jap para sepse unë nuk kam pasë seks me ato kaka);
- Mesazhi nga data 16.6.2007 dërguar në ora 22.34.47 numri telefonik 044 247 074 te numri 044/127-401 (Xik a mundesh të ma sjellish një vajzë ekam një për do ti jap 50 sepse i ka marrëshje me ,nëse mundesh me ma ba këtë të mirë, tregom); duhet të theksohet se Xik është nofka e Lulzimit;

- Mesazhi i 29.1.2008, dërguar në 23.46 nga telefoni 044 386 666 te telefoni 044 433 394 (Merr i disa lastëka (prezervativa))
- Messazhi i 18.1.08, dërguar në 21.03 nga telefoni 044 220 994 te telefoni numër 044 386 666 (Nëse . . . është e lirë. Sjelle te Adora. Rrugës duke u këthyer nga Prizreni do të ju pres atje. Njoftom me sms. Gjithë të mirat . . .);
- mesazhi of 25.1.2008, dërguar në 21.08 nga telefoni 044 798 646 te telefoni 044 386 666 (Sadik nëse . . . është e lirë kisha dasht me qenë me te sonte. Kam qenë në bar deri tash. Por nuk e kam ditë se a është e lirë. Nëse është e lirë më informo. Unë të pres te vendi);
- mesazhi i 28.12.2007, dërguar në 20.04 nga telefoni numër 044 386 666 te telefoni numër 044 433 394 (. . . është e nxanë dhe . . . ka thanë se ai njeriu nga Peja do të vij);
- messazhi i 17.5.2007, dërguar në 01:19:36 nga telefoni 044/893-802 te telefoni 044/127-401 (Bukurosh nëse nuk ke shku në shtëpi, a mund të vish dhe të na marrish mu dhe . . . sepse klientët tanë kanë shkuar).

Mesazhet (që të gjitha janë nga vitet 2007 dhe 2008) tregojnë se deklarata e dhanë nga Lulzim Thaqi nuk është e vërtetë kur deklaroi se nuk ka qenë aspak i përzier kur bëhe5 fjalë për kafen Makuba

Gjithashtu, shembull i përfshirjes së Sadikut është biseda telefonike në mes të tij dhe . . . me 14 tetor 2007 ku roli i Sadikut si personit udhëheqës për të mundësuar shërbimet seksuale nga vajzat është i pamohueshëm. Edhe pse me kokfortësi mohohet nga i pandehuri Sadik Thaqi, nuk ka dyshim se njeri nga zërat e bisedave telefonike është ai i Sadikut, pasi që njeri nga dz personat që kanë biseduar qartazi quhet Sadik dhe është në posedim të telefonit që është pronë e sadik Thaqit.

Prova tjera kundër të pandehurve dalin nga dëshmia e . . . ku qartazi thuhet se Sadiku ishte ai i cili i dërgonte vajzat te hotelet ku ato banin seks me klientët. Në fund, nga ana e të pandehurve nuk është parashtruar asnjë shqarimi i besueshëm dhe logjik i cili sjell deri te përfundimi se ata nuk ishin duke u marr me aktivitetet joligjore.

Përkundrazi, asnjë provë nuk është parashtruar se Lulzim Gashi dhe Sadik Thaqi janë marr me aktivitetet joligjore para vitit 2007 pasi që Prokurori publik nuk ka qenë në gjendje të sjell prova për këtë për periudhën para viti 2007. Lulzim dhe Sadiku kanë pasë dy kafene (klube nate), Vala dhe Makuba dhe në këto lokale kanë punuar disa femra si vallzuese ekzotike dhe vallzuese te tavolinat. Mirëpo, për periudhën para vitit 2007, nuk ka asnjë provë të parashtruar se femrat që kanë punuar në këto dy lokale janë marr edhe me shërbime seksuale.

Dhe natyrisht nuk mundet lehtë të përfundohet se edhe pse aktivitetet që janë zhvilluar nga ana e të pandehurve nga viti 2007 deri kur janë arrestuar ishin aktivitetet joligjore, dhe aktivitetet që janë zhvilluar para vitit 2007 kanë qenë gjithashtu joligjore.

Gjithashtu nga dëshmitë dhe deklaratat e dhana nga palët e dëmtuara dhe nga sjellja e tyre në seancën kryesore del se femrat nuk kanë qenë të obliguara apo në ndonjë mënyrë të detyruara që të punojnë si prostituta dhe se kanë mundë lirisht të kthehen në shtetet e tyre. Në të vërtetë prokurori nuk ka parashtruar asnjë provë, se për shembull, pasaportat

etyre janë mbajtur nga menaxheri i lokalit. Prandaj, rekonstruimi faktual i ngjarjeve djell te përfundimi se nuk ka pasë ndonjë shtrëngim nga ana e të akuzuarve ndaj femrave, që ato të punojnë si prostituta.

Më tej, nga deklaratat e njejta që janë dhanë nga ana e të pandehurve, del se ata kanë dërguar para në Moldavi për të paguar për shpenzimet e udhëtimit të vajzave që do të pranoheshin në punë në Makuba dhe se parat vajzat i kanë kthyer pasi që kanë arritë në Kosovë dhe kanë filluar të punojnë dhe të fitojnë para.

Deklaratat janë të vërtetuara plotësishtë nga shënimet financiare që janë marrë gjatë hetimeve dhe të cilat dëshmojnë se të pandehurit e lartpërmendur kanë dërguar në Moldavi në vitet 2007 dhe 2008 gjithsejtë 25.190€ (shif shënimet financiare në faqet 232 deri 235 të dosjes gjyqësore). Nga këto 25.190 €, vetëm 5.220 janë dërguar nga Shqiprim Uka dhe prandaj ai mund të konsiderohet përgjegjës vetëm për këtë sasi, pasi që nuk ka prova se ai ka dërguar shuma thera parash në Moldavi.

Nga deklaratat e sipërpërmendura të të pandehurve Sadik dhe Lulzim Thaqi, duket se këto para janë dërguar dhe transferuar me qëllim të promovimit dhe lehtësimit aktivitetet joligjore për angazhimin e femrave për shërbime seksuale, për ti siguruar femrast të vijnë nga Moldavia në Kosovë, femrat të cilat duhej të punonin si kamariere, por janë punësuar nga që të dy Thaqit që të punojnë si prostituta. Gjetjet faktike, pavarësisht nga pohimet e prokurorit, demonstrojnë se vetëm transferet e viteve 2007 dhe 2008 kanë pasë qëllim që të lehtësojnë aktivitetet rreth regrutimit nga ana e Lulzim dhe Sadik Thaqit (në të vërtetë, sikurse që më herët është indikuar, nuk ekzistojnë prova se para vitit 2007, të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ngarkohen).

Sa i përket origjinës ilegale të parave që janë dërguar në Moldavi, duhet të theksohet se përmes shënimeve financiare që janë marrë për vitet 2006, 2007 dhe 2008, në lidhje me të pandehurit nuk janë gjetë burime tjera të të ardhurave përpos lokalit Makuba. Prandaj është e pamohueshme se parat e dërguara në Moldavi në të vërtetë kanë qenë nga fitimet e lokalit Makuba, dhe prandaj, pasi që aktiviteti kryesor i lokalit ka qenë ofrimi i shërbimeve seksuale, të prfituara nga aktivitetet e regrutimit të ndërmara nga na e Lulzim dhe Sadik Thaqit dhe nga bashkëpunorët të tyre Shqiprim Uka.

Sa i përket Ali Xërxa, duhet të thuhet se gjatë gjithë gjykimit nuk ka dalë asnjë provë vendimtare e cila do të dëshmonte se ai ka pasë dijeni se paratë që janë dërguar në Moldavi përmes agjencionit të tij Western Union në Gjakovë janë në të vërtetë fitimet e veprimeve joligjore. Edhe pse ka disa papërputhshmëri në deklaratën e të pandehurit të dhanë në gjykatë dhe edhe pse procedura të cilën i pandehuri e zbatuar në lidhje me transferet në emër të Lulzim Thaqit, në disa raste ka qenë jo në pajtim me rregullat e mbrendshme të Western Union, asnjëherë nuk është vërtetuar fakti se ai ka qenë në dijeni për prejardhjen joligjore të parave.

Prandaj, për shkak të strukturës së veprës penale Shpëlarja e parave, pa këtë dijeni të prejardhjes së parave, i pandehuri Xërxa nuk mund të konsiderohet përgjegjës për veprimet e tija.

Sa i përket pozitës së Shqiprim Uka, përfshirja e tij në aktivitetet e regrutimit të cilat i kanë zhvilluar Sadiku dhe Lulzimi është evidente dhe e vërtetuar: në lidhje me këtë, mesazhet e dërguara nga Shqiprimi Sadikut me 28.7.2007, ku dërguesi e informon

pranuesin se ai i ka marr parat nga klientët dhe prandaj dhoma në hotel mund të rezervohet, shqaron pa ndonjë dyshim të muindhsëm rolin e bashkëpunimit të Shqiprim Ukës.

Fakti se Shqiprimi nuk ka qenë vetë një banakier, por bashkëpuntor i dy Thaqive, plotësisht i përfshirë në aktivitetet e tyre të rekrutimit, e vërteton edhe ... e cila në deklaratën e saj thot se Shqiprim i ka ndihmuar menaxherit për ta organizuar punën.

Pasi që aktiviteti i Lulzimit dhe Sadikut ishte aktivitet i rekrutimit (dhe jo i personave të cilët merren me trafikim të qenjeve njerëzore) dhe se aktivitetet e Shqiprimit kanë qenë vetë dytësore me ato të dy Thaqive, provat të cilat shfaqen kundër këtij vetëm tregojnë se ai ka kryer veprën penale Dhënia e ndihmës në ushtrimin e prostitucionit.

Prandaj, në bazë të nenit 386 të KPPK, pasi që gjykata nuk kufizohet me kualifikimet ligjore të parashtruara nga prokurori, në lidhje me Shqiprim Ukën, akuzat për *Trafikim me qenje njerëzore* duhet të rikualifikohen si akuza për *Dhënia ndihmës në ushtrimin e prostitucionit*.

1. Parashtrësia e palëve

Avokatët e mbrojtjes vazhdimisht kanë kërkuar që provat të siguruara përmes masve të fshehta të shpallen si të papranueshme dhe deklaratat e dëshmitarëve të mbledhura në fazën paraprake të shpallen të papranueshme.

Saktësisht Avokatët e mbrojtjes kanë theksuar si në vijim:

1. sipas nenit 264 paragrafi 3 i KPPK, gjyqtari i cili e ka zhvilluar procedurën e konfirmimit të aktakuzës do të shqyrtoj, para se aktakuza të merr formën e prerë pranueshmërine e materialeve të mbledhura sipas detyrës zyrtare. Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesa Kolegjit penal të tre gjyqtarëve; në këtë rast, Gjyqtari i procedurës paraprake nuk i ka dorëzuar avokatëve të mbrojtjes aktvendim për këtë qështje, dhe nuk ju ka mundësuar të drejtën për ankesë;
2. Gjyqtari i procedurës paraprake në arsyetimin e tij parashtron se raportet që kanë të bëjnë me nenet 259, 260 dhe 262 të KPPK dhe me masat e fshehta nuk janë gjetur në dosjen e lëndës gjyqësore, prandaj përgjimi i bisedave tektelefonike nuk është kryer në bazë të ligjit; avokatët e mbrojtjes gjithashtu kanë kërkuar që të gjitha provat në lidhje me vëzhgim duhet të deklarohen si prova të papranueshme, pasi që nuk ka pasë urdhër për vëzhgim të nxjerr nga prokurori;

Gjithashtu Avokatët i mbrojtjes kanë kërkuar vazhdimisht të krhen dy ekspertiza:

- a) ekspertizën për analizën autencitetin e telefonit dhe vëzhgimin e mesazheve, që të vërtetohet se sipas një informate nga OESB prej tetorit 2006 deri me janar 2007, për shkak të problemeve teknike prokurorët ndërkombëtar nuk ka mund të bëjnë përgjimin e bisedave telefonike

b) ekspertizën financiare për të vërtetuar se dispozitat nga aktakuza që kanë të bëj me transferin e parave janë “të papërcaktuara, të paqarta, të pabazuara”;

Në fund Avokatët e mbrojtjes kanë kërkuar që të gjitha deklaratat e dhana nga dëshmitarët gjatë fazës hetuese të shpallen të papranueshme, sepse dëshmitarët janë dëgjuar pa prezencën e të pandehurve dhe të avokatëve të tyre mbrojtës.

Në lidhje me këtë kërkesë, Trupi gjykues e vërteton mendimin të cilin e ka shprehur në aktvendimin e lëshuar me datën 19.02.2009 i cili është si në vijim:

“1. Sikurse që e ka theksuar Gjyqtari i procedurës paraprake në aktvendimin e tij të datës 16 shtator 2008, nuk është e domosdoshme të lëshohet aktvendimi i posaçëm për pranueshmërinë e provave të mbledhura gjatë aplikimit të masave të fshehta.

Neni 254.3 i KPPK kërkon një aktvendim të shkruar në lidhje me këtë qështje, aktvendim i kundër të cilit mund të partashtrohet ankesë.

Ky nen nuk e ndalon qështjen e marrjes aktvendimit brenda një marrje të vendmit më të gjërë gjatë konfirmimit të aktakuzës.

Neni 306.3 parashef aktvendim të posaçëm vetëm në rast se disa pjesë të provave janë shpallur të papranueshme.

Kjo do të thotë se nëse të gjitha provat janë pranuar si të pranueshme, atëherë gjyqtari nuk është i obliguar që ato ti shpallë si të pranueshme.

Kjo gjithashtu vërtetohet edhe me nenin 264.3 i cili e identifikon gjyqtarin i cili duhet të shqyrtojë pranueshmërinë e provave që janë mbledhur gjatë ushtrimit të masave të fshehta, si gjyqtari “i cili e zhvillon procedurën për konfirmimin e aktakuzës”: kjo do të thotë i njëjti gjyqtar për të dy aktvendimit, të cilat e plotësojnë njera tjetrën: pranueshmërinë e provave dhe konfirmimin e aktakuzës.

Përfundimi është se aktvendimi i Gjyqtari i procedurës paraprake për konfirmimin e aktakuzës në të njëjtë kohë, sa i përket formës, i plotëson të dy kërkesat e KPPK, atë për shqyrtimin e pranueshmërisë së provave (264) edhe atë për konfirmimin e aktakuzës.

Që të dyja mund të ankohen.

Avokati i mbrojtjes thekson se ai nuk ka qenë i informuar për vendimin për pranueshmërinë e provave (të siguruara gjatë zbatimit të masave të fshehta) dhe prandaj nuk ka mund të parashtrij ankesë kundër tij.

Përkundrazi, aktvendimi në lidhje me nenin 264 të KPPK është i përfshirë në vendim më të gjërë, në atë për konfirmim të aktakuzës.

Duhet të vërrehet se nuk mvarret nga kolegji prej tre gjyqtarëve që vlerësimet se a është dashitë të shqyrtohen cilësitë e ankesës të parashruar kundër aktvendimit për konfirmimin e aktakuzës, ankesa e cila përmbante disa vërrejtje në lidhje me vlerësimin e provave, do të duhej të shqyrtohej nga kolegji prej tre gjyqtarëve apo thjeshtë të refuzohej nga arsyet procedurale.

Mirëpo në këtë rast nuk mund të shifet ndonjë shkelje e të drejtave themelore të të pandehurit për shkak të faktit se ankesa e Avokatt të mbrojtjes në lidhje me vlerësimin e provave nga ana e Gjyqtarit të procedurës paraprake nuk ka mund të merret sipas rregullave në shqyrtim nga ana e Kolegjit penal.

Kjo është nga shkakun se Avokati i mbrojtjes e ka mundësinë efektive që të kërkojë nga trupi gjyqësor që të përjashtojë provat e shpallura të pavlefshme nga shkaqet e përmendura në ankesën e tij kundër aktvendimit të Gjyqtarit të procedurës paraprake sipas nenit 264.3 të KPPPK.

Dhe kjo është saktësisht përbërja e propozimit të tanishëm të mbrojtjes në këtë lëndë.

2.Sa i përket raporteve për implementimin e masave të fshehta, të cilat, në bazë të nenit 259.2 të KPPPK, Policia gjyqësore duhet të ja parashtrijë Oficerit ligjor të autorizuar, duhet të përmendet se ato nuk janë të pranishme në dosjen e lëndës, prandaj nuk ekuzistojnë provat se këto Raporte janë përpiluar nga policët të cilët i kanë zbatuar masat e fshehta.

Dispozita e cila ka të bëjë me dorëzimin e raporteve nga policia çdo 15 ditë e ka qëllimin e qartë që të ja mundësojë oficerit ligjor të autorizuar të kontrollojë implementimin e masës dhe rregullsinë e masës në periudha të caktuara kohore.

Por, pasi që është vërtetuar se raportet 15 ditore nuk ekuzistojnë në dosjen e lëndës, duhet të sqarohet se cilin fat duhet ti caktohet provave të cilat janë mbledhur gjatë masave të zbatuara të fshehta pa parashtrimin e raporteve 15 ditore.

Është e qartë se mungesa e raporteve 15 ditore ka si pasojë shkeljen e dispozitave të procedurës penale të paraparë në nenin 259, paragrafi 2 i KPPPK, por është e nevojshme të vlerësohet se cila është rëndësia e kësaj shkelje.

Në të vërtetë, sipas nenit 153 të KPPPK "provat e mbledhura duke u shkelur dispozitat e procedurës penale nuk do të pranohen kur...ligji e parashef këtë shprehimisht".

Duhet të përmendet se nuk është gjetur asnjë nen i cili e deklaron se pa raportet 15 ditore, provat e mbledhura me masat e fshehta do të konsiderohen të papranueshme. Por, për të mund të vlerësohet pranueshmëria e provave, duhet të merret parasysh edhe neni 403 i KPPPK. Në të vërtetë, sipas paragrafit 2 të nenit të lartpërmendur, për të mund të vlerësohet pranueshmëria e provave, duhet të shifet se a ka ndodhur shkelja esenciale e dispozitës së procedurës penale apo jo. Dhe sipas pikave 1) dhe 2) të paragrafit të lartpërmendur 2, ekziston shkelja e konsiderueshme vetëm nëse është harruar të aplikohet dispozita e kodit të tanishëm ose nëse janë shkelur të drejtat e të pandehurit dhe kjo ka ndikuar apo ka mund të ndikoj në nxjerrjen e aktgjyqimit të ligjshëm dhe të drejtë. Dispozitat në lidhje me obligimin për të parashtruar raportet kanë të bëjnë vetëm me fazën ekzekutive të masave të fshehta.

Kjo nuk ndikon në ligjshmërinë e aktvendimit me të cilin kolegji penal i ka aprovuar masat e fshehta.

Pa harruar se qëllimi i raportit 15 ditore është që të lejohet oficeri ligjor i autorizuar dhe prandaj edhe palët në procedurë që të kontrollojnë implementimin e masës dhe rregullsinë e sajë, nuk duket se kjo shkelje e procedurës mund të shkelë të drejtat e të pandehurit apo të ndikoj në marrjen e aktgjyqimit ligjorë dhe të drejtë.

Në të vërtetë, nga dosja e lëndës, që gjindet në disponim të mbrojtjes, mund të vëtetohet se vetëm numnrat e telefonit që i janë nënshtruar urdhërit ligjor për masa të fshehta janë monitoruar dhe se masat e fshehta janë implementuar gjatë kohës së caktuar me ligj, dhe sa i përket modalitetit, me instrumente të cilat janë në posedim ligjorë të organeve të rendit.

Përmes urdhërave të lëshuara nga ana e Gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nga ana e Prokurorit dhe përmes bisedave dhe mesazheve të siguruara, Avokatët e mbrojtjes kanë pasë mundësinë ta kontrollojnë ligjshmërinë e implementimit të masave të fshehta.

Prandaj nuk mund të pohohet se në ndonjë mënyrë janë shkelur të drejtat e mbrojtjes dhe se provat e siguruar përmes masave të fshehta të përgjimit të bisedave telefonike dhe matjeve telefonike duhet të konsiderohen si prova të pranueshme.

Përkundrazi, në lidhje me pranueshmërinë e provave duhet të merret një vendim i ndryshëm kur bëhet fjalë për fotografitë të cilat i ka ba policia duke vëzhguar disa lokale dhe hotele me pretendim se kanë të bëjnë me hetimet.

Në lidhje me këto fotografi asnjë urdhër për vëzhgim nuk është gjetur në dosje. Kuptimi i masave të fshehta të vëzhgimit është shqaruar në nenin 256 të KPPPK: vëzhgimi është monitorimi, përcjellja apo incizimi i persoave, të lëvizjes së tyre apo të aktiviteteve tjera, që është autorizuar në mënyrë të rregullt nga oficeri i policisë ligjore.

Pasi që nuk është lëshuar asnjë urdhër për vëzhgim nga ana e Prokurori publik, fotografitë e incizuara nga policia gjatë aktiviteteve të tyre të monitorimit duhet të shpallen si prova të papranueshme.

3. Sa i përket vërrejtjeve të propozuara nga ana e avokatit të mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë e përgjimeve në përgjithësi dhe të mosqenit në mundësi të zbatohet masa e fshehtë në mënyrë të rregullt në periudhën tetor 2006 deri me janar 2007, duhet të thuhet se këto vërrejtje janë të pacaktuara, dhe që nuk kanë të bëjnë me provat nga kjo lëndë dhe prandaj nuk janë vërrejtje të pranueshme.

4. Ekspertiza për të vërtetuar se kush njanë në të vërtetë përdoruesit e telefonave që monitoroheshin është shpall nga trupi gjykoës si e panevojshme në këtë lëndë. Anë të vërtetë të pandehurit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shqiprim Uka, në deklaratat që i kanë dhan prokurorit kanë pranuar se telefonat që ata i përdorin janë 044 127 401, 044 829 797, 044 433 394 (Lulzim Thaqi), 044 386 666 (Sadik Thaqi) dhe 044 432 235 (Shqiprim Uka).

I pndadhuri Lulzim Thaqi ka deklaruar gjithashtu në intervisten e tij se numri 044893802 përdorej nga

Duhet të përjashtohet mundësia se dikush tjetër ka përdorë këta numra telefonik, sepse në disa mesazhe dhe përgjime telefonike qartazi tregohen emrat e Sadikut apo Lulzimit apo të nofkave të tyre që qartazi sjellin deri te ata. Gjithashtu edhe përbërja e mesazheve përputhet me deklaratat e dhana nga të pandehurit në lidhje me faktin se Lulzimi, Sadiku dhe Shqiprimi kanë pasë të paktën diçka të bëjnë lokalet që ishin duke u hetuar.

Të gjitha këto rethana sjellin te përfundimi se numrat telefonik të përmendur më lartë, jasht çdo dyshimi të arsyeshëm, i kanë takuar të pandehurve dhe prandaj nuk është e nrvojshme për ekspertizë fonike (nuk është e vlefshme pasiqë do të ishte e papërdorshme në lidhje me mesazhet).

5. Sa i përket ekspertizës financiare të kërkuar nga Avokatët e mbrojtjes, duhet të vërrehet se shënimet financiare të siguruara nga prokurori gjatë hetimeve i sqaron në mënyrë të gjithanshme dhe në mënyrë të saktë datate transfereve të parave, sasi të,

destinimin e parave, kush ka qenë dërguesi dhe kush pranuesi dhe prandaj, nuk ka nevojë, për një ekspertizë tjetër e cila do të ishte plotësisht e panevojshme.

6. Sikurse që është vërrejtur nga Gjyqtari i procedurës paraprake, vendimi në lidhje me dëgjimin e dëshmitarëve gjatë procedurës në fazën paraprake, i jep prokurorit thjeshtë të drejtë, pa obligim korrespondent, që ta lejoj të pandehurin dhe avokatin e mbrojtjes (së të pandehurit) që të jetë i pranishëm në këtë qështje.

Në këtë rast nuk ka ndodhë se ka pasë shkelje nga neni 237 t KPPK.

Sikurse që është theksuar në aktvendimin e këtij trupi gjykues në seancën e datës 3 shkurt 2009, dispozitat e nenit 78 të KPPK janë në intzers të palës së dëmtuar dhe jo në interes të të pandehurit, të cilit nuk i shkon për shtati të ngrej qështjen se a është ftuar përfaqësuesi i palës së dëmtuar në seancë apo jo kur është intervistuar pala e dëmtuar nga prokurori.

Pranueshmëria e provës kërkon që dëshmitari, i dëgjuar nga prokurori, duhet të intervistohet (ballafaqohet) me të pandehurin apo me avokatin e tij "gjatë ndonjerës nga fazat e procedurës penale" (neni 156.2 i KPPK), dhe në këtë rast kjo ka ndodhur gjatë shqyrtimit kryesor.

Pas aktvendimit të datës 19.02.2009, Avokati i mbrojtjes ka ngritur vërrejtje të reja, por të gjitha propozimet janë refuzuar me aktvendim të datës 24.02.2009, që është si në vijim:

1. Në propozimin e tij Avokati i mbrojtjes ngrit vërrejtjen në lidhje me pranueshmërinë e provave të siguruara në bazë të implementimit të masave të fshehta dhe tenike të vëzhgimit dhe hetimeve, të parapara në Kapitullin XXIX të KPPK.

Avokati i mbrojtjes pohon se sipas vendimit të Gjyqtarit të procedurës paraprake (faqe 14 e vendimit të datës 16 shtator 2008, veruzioni shqip) raportet 15 ditore në lidhje me implementimin e masave të fshehta nuk gjenden në dosjen e lëndës dhe përgjimet telefonike prandaj nuk janë kryer në bazë të ligjit.

Sipas Avokatit të mbrojtjes, kjo deklaratë e Gjyqtarit të procedurës paraprake ka pasë dinjitetin e vendimit për papranueshmërinë e këtyre provave, ky vendim ka marrë formë të prerë (res iudikata) dhe trupi gjykues nuk ka mund ta revokoj apo ndërroj. Si konsekuencë, të gjitha provat duhet të shpallen të papranueshme.

Mirëpo, trupi gjykues nuk e ndan mendimin e Avokatit të mbrojtjes.

Gjyqtari i procedurës paraprake (faqe 18 të vendimit të tij të datës 16 shtator 2008) i cili thot se raportet 15 ditore po mungojnë nga dosja e lëndës, dhe prandaj nga ky shkak përgjimi nuk është zbatuar në përputhje me ligjin, mirëpo ka shtuar se këto raport kanë mund të dorëzohen nga ana e Prokurorit publik deri në seancën kresore, dhe ka vlerësuar se prandaj, se "është tepër herët që të vihet në përfundim se përgjimet telefonike kanë qenë të paligjshme".

Prandaj Gjyqtari i procedurës paraprake nuk marr ndonjë vendim në lidhje me papranueshmërinë e këtyre provave.

Pasi që nuk është marr vendimi atëherë, rrjedhë se nuk mund të ketë Res Iudikata

Sikurse që është vërrejtur në aktvendimin e këtij trupi gjykues të datës 19 shkurt 2009, mungesa e raporteve 15 ditore paraqesin vetëm një parregullsi në fazën e implementimit

dhe nuk paraqesin shkak për papranueshmërinë e provave të siguruara përmes masave të fshehta.

2. Me vërejtjen e dytë Avokati i mbrojtjes thirret në një raport të OESB në lidhje me problemet teknike gjatë përgjimit të telefonave në periudhën nga tetori 2006 deri në janar 2007.

Sipas këtij raporti, me 31 tetor 2006, Drejtorati i UNMIK-ut për krim të organizuar i ka informuar prokurorët ndërkombëtar për një "prishje serioze" të sistemit, mpa shqaruar detaje; prandaj, sipas këtij raporti, policia nuk ishte në gjendje të implementoj urdhërat për përgjime dhe kjo e metë i ka penguar hetimet: "Autoritetet relevante mund ta kenë shkelur ligjin lokal duke mos e mirmbajtur sistemin për përgjim që është i paraparë me dispozitat e KPPK, në lidhje me teknikat hetimore që janë në dispozicio të prokurorisë".

Sikurse që edhe është vërrejtur në vendimin e 19 shkurtit 2009, këto vërejtje janë të përgjithësuara, të papërcaktuara, nuk kanë relevancë me provat e kësaj lënde dhe si të tilla janë të papranueshme.

Gjithashtu vlenë të përmendet se zbatimi i masave të fshehta në këtë lëndë (përgjimi i bisedave telefonike dhe mesazheve) ka të bëjë me periudhën (tetor deri në dhjetor 2007) që nuk është e njëjtë nga ajo që është marrë në konsiderim gjatë vërrejtjes së ngritur nga avokati.

Sa i përket mesazheve të periudhës nga dhjetori 2006 deri në korrik 2007, ato janë kërkuar përmes një urdhëri për matje me qëllim të mblidhen mesazhet tashma që janë dërguar dhe pranuar, dhe prandaj raporti i lartpërmendur, i drejtuar ndaj aktiviteteve të përgjimit, nuk ka ndonjë relevancë me qështjen.

Së dyti, duhet të vërrehet se "problemet teknike" të cilat kanë mund të krijojnë vështirësi për zbatimin e masave të fshehta, nuk janë të saksuara.

Ky trup gjykues e ka nënvizuar se "përmes urdhërave të lëshuara nga ana e Gjyqtarit të procedurës paraprake dhe të Prokurorit dhe përmes bisedave dhe mesazheve të siguruara, mbrojta ka mund të vërtetoj ligjshmërinë e implementimit të masave të fshehta" (Aktvendimi 19 shkurt 2009, faqe 4).

Nuka ka prova specifike të cilat tregojnë ekzistimin, në këtë lëndë, të problemeve teknike të cilat kanë mund të ndikojnë në implementimin e masave të fshehta. Nuk është parashtruar ndonjë provë nga ana e mbrojtjes për të mbund të mbështetet pohimi se në këtë rast autoritetet "ndoshta" kanë shkelur ligjin vendor.

3. Me vërrejtjen e tretë, Avokati i mbrojtjes kundërshton se masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimet mund të shpallen si prova sepse ato duhet të konsiderohen aktivitete hetimore.

Gjithashtu, sipas Avokatit të mbrojtjes, këto aktivitete hetimore kanë shkelur të drejtën e fshehtësisë së letrave, telefonave dhe komunikimeve tjera, që garantohet me nenin 36 të Kushtetutës së Kosovës, si e pacenueshme.

Trupi gjykues e ndan mendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake në lidhje me këtë aktvendim (faqe 16 dhe ff) në lidhje me atë se nuk ka shkelje të së të drejtës së të

pandehurit përmes këtyre masave të fshehta dhe në lidhje me natyrën e provave dhe të rezultateve të masave të fshehta. Në të vërtetë, neni 152.2 i KPPK e njëh të drejtën e gjykatës që të vlerësojë pranueshmërinë e provave të cilat mendohet se janë të rëndësishme.

Nuk ka pasë propozime nga palët e dëmtuara dhe nga përfaqësuesit e tyre.

C. KUALIFIKIMI LIGJOR

1. Vlerësimi ligjor i fakteve nga ana e Gjykatës

- **Akuza 1: Trafikimi me njerëz në bashkëpunim**

Sipas Nenit 139, KPPK, *trafikimi me njerëz*, një sërë sjelljesh apo veprimesh duhen ndërmarrë nga i akuzuari në mënyrë që ky të dënohet për veprën e lartpërmendur penale. Në fakt, gjatë gjithë procedurës, Prokurori Publik nuk ka paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar që të pandehurit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shqiprim Uka kanë kryer një ndër veprimet e përcaktuara me Nenin 139, KPPK. Në fakt, nuk ka ndonjë provë që të pandehurit kanë kërcënuar, kanë përdorur forcë apo ndonjë formë tjetër të detyrimit, apo kanë rrëmbyer viktimat për të përdorur apo siguruar shërbime seksuale.

Në të njëjtën mënyrë, Prokurori nuk ka sjellë asnjë provë që vërteton ndonjë hile apo mashtrim të kryer kundër viktimave, për qëllimin e përcaktuar me Nenin 139, KPPK.

As arsyetimi i Gjykatës të Procedurës Paraprake, i cili vërejti keqpërdorimin e fuqisë në sjelljet dhe veprimet e të pandehurve, mund të pranohet për shkak të mungesës që femrat fillimisht janë punësuar për të punuar si punëtore dhe pastaj në njëfarë mënyre janë detyruar të punojnë si prostituta. Në fakt, dosja e lëndës nuk përmban asnjë provë që len të kuptohet që vetëm pas ardhjes së tyre në Kosovë, viktimat e kuptuan që do të duhet në punojnë në Makuba si prostituta në vend të punës si kamariere.

Është më se e qartë që kontratat e punësimit, të nënshkruara nga femrat janë një lloj mbulese për të dhënë imazhin që Makuba ishte një klub nate i zakonshëm dhe nuk ishte vend që ofronte mundësinë për të paguar femra për shërbime seksuale. Megjithatë nuk është vërtetuar që para nënshkrimit të kontratës, të pandehurit nuk i kanë informuar viktimat që do të punojnë edhe si prostituta në Makuba.

Së fundi, nuk ka ndonjë provë që vërteton një pozicion të ndieshmërisë tek ana e viktimave. Do të kuptohej një pozicion i tillë nëse për shembull, gjatë shqyrtimit kryesor ka dalë në pah që viktimat nuk kanë pasur mundësinë të largohen nga Kosova pa pajtimin e shefave të tyre apo që viktimat nuk kanë pasur liri të përdorimit të pasaportës së tyre. Edhe pse pretendohen nga Prokurori, situatat e tilla nuk janë vërtetuar gjatë shqyrtimit kryesor.

Sa i përket pozicionit të Shprim Ukës, si dhe të atij të Lulzim Thaqit dhe Sadik Thaqit, nuk mund të thuhet që ka kryer veprën penale *trafikim me njerëz* sepse sipas vlerësimit të provave të lartpërmendura, nuk duket që ka kryer ndonjë prej veprimeve të parapara me Nenin 139, KPPK.

- **Akuza 2: Pastrim parash**

Elementet përbërëse të veprës penale *Pastrim parash* (pjesa 11.2 e Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2004/2, Neni 10.2 (d), ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/53), në mesin e të tjerave si në vijim:

- Pasuria buron nga aktivitetet kriminale;
- Dijenia apo shkak i dijës që pasuria buron nga aktiviteti kriminal;
- Kthimi apo transferi i pasurisë së tillë për një ndër qëllimet e përmendura në ligj siç është promovimi i aktivitetit të përmendur kriminal.

Sa i përket elementit të parë, të gjitha provat e paraqitura dhe të marra në konsideratë gjatë shqyrtimit kryesor, tregojnë qartë që të gjitha të hollat e fituara nga Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shprim Uka nëpërmjet Klub Makubës duhet të merren në konsideratë si të holla të fituara nëpërmjet ushtrimit të aktivitetit të mundësimit të prostitucionit ngase aktiviteti kryesor që zhvillohej në Makuba Klub (apo më mirë të thuhet aktiviteti i vetëm duke e marrë në konsideratë që servimi i pijeve ishte vetëm diçka përcjellëse) ishte aktiviteti i prostitucionit. Prandaj, me të drejtë mund të thuhet që të gjitha të hollat që janë fituar nëpërmjet këtij klubi duhet të konsiderohen burime nga vepra penale e mundësimit të prostitucionit.

Sa i përket elementit të dytë, pasi që të pandehurit e lartpërmendur ishin të përfshirë në aktivitetin e ndërmjetësve, nuk mund të mohohet që ishin në dijeni për origjinën e paligjshme të të hollave.

Sa i përket elementit të tretë, të pandehurit në mënyrë të qartë e pranuan në deklaratat e tyre që kanë dërguar të holla në Moldovë kryesisht për të paguar biletat e udhëtimit të femrave që do të punësohen (apo që veç janë punësuar) si prostituta në Makubë dhe që të hollat janë kthyer nga ato pasi që kanë arritur në Kosovë (apo janë kthyer në Kosovë).

Prandaj, është vërtetuar që të hollat që ishin burim i aktivitetit kriminal janë transferuar me qëllim të promovimit të aktivitetit kriminal në fjalë, *id est* aktivitetit të mundësimit të prostitucionit.

Të gjitha transferet në Moldovë, të kryer nga Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shprim Uka në vitet 2007 dhe 2008 në mënyrë analitike ceken në faqet 232 deri në 235 të dosjes së lëndës dhe përmendin dërguesin, pranuesin, destinacionin, shumën, dhe datën e dërgimit të të hollave. Edhe pse disa shuma janë dërguar nga Lulzimi dhe disa të tjera nga Sadiku, nuk ka efekt të dallohen shumat e ndryshme në mes vete pasi që këta ishin bashkëmenaxherë të klubit dhe duhet të konsiderohen si përgjegjës në bashkëpunim për të gjitha të hollat e dërguara në emrin e tyre në Moldovë.

- **Akuza 3: Mundësimi i prostitucionit**

Neni 201, KPPK, *Mundësimi i Prostitucionit*, përfshin një numër sjelljesh dhe veprimesh që duhen ndërmarrë nga i akuzuari në mënyrë që ky të dënohej për veprën e përmendur penale. Në veçanti, thuhet që në mënyrë që një person të jetë përgjegjës për veprën penale të lartpërmendur, duhet të punësojë, organizojë dhe asistojë një person tjetër apo të sigurojë lokalim personit tjetër për qëllim të prostitucionit. Është e pamohueshme që

për të kryer veprën penale të lartpërmendur, jo të gjitha sjelljet dhe veprimet e përmendura në Nenin 201 duhet të kryhen, por që mjafton të kryhet një prej tyre.

Aktualisht, vlerësimi i provave të paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor tregon përtej çdo dyshimi të bazuar që Lulzim Thaqi dhe Sadik Thaqi me dëshirë kanë rekrutuar, organizuar dhe kanë ofruar lokale për të paktën disa femra që punonin në Makuba për qëllim të prostitucionit.

Është poashtu e pamohueshme që Shkrim Uka u kishte ndihmuar dy Thaqëve në aktivitetin e tyre si ndërmjetës të femrave që punonin në Makuba Club dhe si bashkë-kryerës ka kryer të paktën organizimin, vlerësimin dhe ofrimin e lokaleve për disa nga femrat që punonin në Makuba për qëllim të prostitucionit. Nuk ka asnjë provë që femrat ishin të detyruara apo të kërcënuara të ushtrojnë aktivitetin e prostitucionit dhe prandaj, kualifikimi ligjor i sjelljes dhe veprimit të të pandehurve duhet klasifikuar nën paragrafin e parë të Nenit 201, KPK (dhe jo nën paragrafin e tretë).

D. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

Gjatë caktimit të dënimit penal, gjykata duhet ta ketë parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit – pra shtypjen e aktiviteteve shoqërisht të rrezikshme duke i frenuar të tjerët në kryerjen e veprave të ngjashme kriminale – dhe qëllimeve specifike, parandalimin e kryerësit në kryerjen e sërishme të veprave penale dhe rehabilitimin e tij.

Në rasti në fjalë, edhe pse lidhur me veprën e mundësimin të prostitucionit, dënimi prej gjobe është i përfshirë, vetëm dënimi i burgimit mund të arrijë qëllimin e përmendur të dyfishtë. Sigurisht që lidhur me veprën penale të pastrimit të parave, dënimi do të jetë burgimi si dhe gjoba.

Këto ishin raste të rënda të veprave penale, të kryera nëpërmjet disa veprimeve dhe gjatë një periudhe prej një viti. Lidhur me Lulzim Thaqin dhe Sadik Thaqin, rrethanat rënduese janë tronditëse në krahasim me ato lehtësuese: në fakt, kryerësit kanë treguar vendosmëri të veçantë, këmbëngulje dhe pamëshirë në kryerjen e veprave penale. Për më tepër kryerja e veprave penale kërkoi një përgatitje të veçantë, planifikim, dhe angazhim dhe niveli i përgjegjësisë penale të Sadik dhe Lulzim Thaqit duhet të konsiderohet si i lartë pasi që këta ishin ata që drejtonin Klubin Makuba.

Përfundimisht, që të dy janë recidivistë që u dënuan për kryerjen e veprës penale dështim në parandalimin e rrezikut, sipas Nenit 296, KPPK, si dhe veprën penale lëndim të rëndë trupor, sipas Nenit 154, KPPK.

Sa i përket Shqiprim Ukës, duhet të ceket që roli i tij ishte më pak i rëndësishëm, pasi që ky ishte bashkëpunëtor me një pozicion më të ulët dhe prandaj, niveli i përgjegjësisë të tij penale duhet të konsiderohet si më i ulët. Për më tej, vlen të merret në konsiderim mosha e të pandehurit, i cili ishte vetëm 21 vjeç kur kreu veprën penale.

Prandaj, këto dy rrethana lehtësuese duhet të merren në konsideratë për të llogaritur dënimin sa i përket të pandehurit Shqiprim Uka.

Me veprimet e tyre, të akuzuarit kanë kryer dy vepra penale. Me rregullat e llogaritjes së dënimit të kombinuar, dënimi është si të vijim:

për Lulzim Thaqin:

dënimi për veprën penale *Pastrim Parash* është tri vite burgim dhe një gjobë prej €40.000;

dënimi për veprën penale *Mundësimi i Prostitucionit* është një vit burgim;

dënimi i përgjithshëm, për shkak të rregullave të dënimit për vepra penale të përsëritura është tri vite e një tetë muaj burgim dhe gjobë prej €40.000;

për Sadik Thaqin:

dënimi për veprën penale *Pastrim Parash* është tri vite burgim dhe gjoba orej €40.000;

dënimi për veprën penale *Mundësimi i Prostitucionit* është një vit burgim;

dënimi i përgjithshëm, për shkak të rregullave të dënimit për vepra penale të përsëritura është tri vite e tetë muaj burgim dhe gjoba prej €40.000;

për Shqiprim Uka:

dënimi për veprën penale *Pastrim Parash* është një vit e tetë muaj dhe gjoba prej €9.000;

dënimi për veprën penale *Mundësimi i Prostitucionit* është nëntë muaj burgim;

dënimi i përgjithshëm, për shkak të rregullave të dënimit për vepra penale të përsëritura është dy vite burgim dhe gjoba prej €9.000.

E. SHPENZIMET

Të akuzuarit Lulzim Thaqi, Sadik Thaqi dhe Shqiprim Uka janë shpallur fajtorë, ata duhet të kthejnë paratë për shpenzimet e shqyrtimit kryesor me përjashtim të përkthimit (Neni 102, paragrafi 1, KPPK). Pasi që janë liruar nga akuza lidhur me veprën penale të Trafikimit me Njerëz, ata nuk do të ngarkohen me shpenzimet e kësaj akuze nëse këto shpenzime mund të veçohen nga shpenzimet e përgjithshme të shqyrtimit.

Një vendim i veçant mbi shpenzimet do të sjellet nga gjykata kur pranohen të dhënat në fjalë.

F. KËRKESË PËR DËMSPËRBLIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor, palët e dëmtuara janë përkujtuar mbi mundësinë për kërkuar dëmshpërblim gjatë gjykimit kryesor, në pajtim me Nenin 355, para. 2, KPPK. Por, këta deklaruan që nuk do të bëjnë kërkesë për dëmshpërblim.

Prandaj, Gjykata nuk ka pasur nevojë të marrë një vendim të veçant mbi këtë çështje.

Kryetari i Trupit Gjykses
Emilio Gatti

Gjykatësi Raportues
Gianfranco Gallo

Gjykatësi kosovar
Elmaze Syka

Procesmbajtësi
Robert Abercrombie

Këshillë Juridike

Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij vendimi nëpërmjet Gjykatës së Qarkut në Pejë te Gjykata Supreme e Kosovës brenda një periudhe 15 ditëshe nga data e këtij vendimi.

Perkthyer ne gjuhen Shqipe nga versioni origjinal ne gjuhen Angleze